



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 690 Akti

Nr. 723 Vendimi
Tiranë, më 7.12.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Firdes Shuli	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datat 13.11.2023 dhe 5.12.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Edmond Koloshi**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Edmond Koloshi, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VË R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Edmond Koloshi është subjekt i rivlerësimit sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.12.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Edmond Koloshi do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Valbona Sanxhaktari. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli. Në vijim, nga relatorja e çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016.
3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.
4. Me vendimin nr. 1, datë 15.1.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Edmond Koloshi, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioner Olsi Komici. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti deklaroi në rrugë elektronike se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
5. Me vendimin nr. 3, datë 19.10.2023, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh prej relatores së çështjes me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për të tria kriteret, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Edmond Koloshi; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
6. Në datën 24.10.2023, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 8.11.2023; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.
7. Në datën 27.10.2023 subjekti i rivlerësimit ka marrë kopje të akteve të dosjes.
8. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 4, datë 8.11.2023, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore.
9. Në datën 13.11.2023, u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm, dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Pas zhvillimit të seancës dëgjimore të datës 13.11.2023 me vendimin nr. 5, datë 13.11.2023, Komisioni vendosi riçeljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Edmond Koloshi, për arsye se në datën 13.11.2023 u administrua një denoncim ku ngriheshin pretendime ndaj subjektit të rivlerësimit për korrupsion. Gjatë hetimit administrativ shtesë u administruan edhe dy denoncime të tjera ndaj subjektit të rivlerësimit.

11. Në datën 1.12.2023, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit administrativ shtesë, si dhe kalimin në seancë dëgjimore në datën 5.12.2023. Në datën 5.12.2023 u zhvillua seanca e dytë dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

12. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

13. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

14. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

15. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (ii) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar nga AKSIK-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (iii) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja dhe dokumentet shkresore të paraqitura prej tyre; (iv) provat shkresore/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet apo subjektet publike a private; (v) denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit dhe çdo informacion të marrë në rrugë ligjore; (vi) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit; (vii) sugjerime/opinionet të vëzhguesit të ONM-së sipas nenit 49, pikat 10-12 të ligjit.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

VLERËSIMI I PASURISË

16. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Edmond Koloshi ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 26.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, z. Edmond Koloshi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, kur ka dorëzuar deklaratën përpara fillimit të detyrës (në

vijim DPDF) me nr. indeksi *** dhe në vijim, ka dorëzuar rregullisht deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV).

17. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Edmond Koloshi, ka konstatuar se: (a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (ç) nuk ka kryer deklarim të rremë; (d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

18. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Edmond Koloshi, si dhe të personave të lidhur me të.

19. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur në deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV) dhe në deklaratën *Vetting*; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim vërtetimin ose jo të deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit

20. Apartament banimi me sip. 165.9 m², në *, Tiranë,** i paregjistruar në ZVRPP-në Tiranë, i përfituar sipas kontratës për ndërtim apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.9.2009 (në bashkëpronësi me bashkëshorten) lidhur me shoqërinë e ndërtimit “****” sh.p.k. Burimi i financimit: kredi në Raiffeisen Bank, hua (e shlyer) dhe kursime (bashkëlidhur janë kontrata, planimetria, vërtetimi nr. *** prot., datë 22.10.2016, etj.). Vlera: 80.000 euro. Shlyer: 57.600 euro. Pjesa takuese: 50%. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.

20.1. Në lidhje me mënyrën e përfitimit të pasurisë nga aktet në dosje¹, rezulton se:

- Sipas kontratës për ndërtimin e apartamentit, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.9.2009, shtetasit Edmond Koloshi dhe M. K. kanë porositur pranë sipërmarrësit shoqëria “****” sh.p.k. një apartament me sipërfaqe ndërtimore 165.9 m² (përfshirë verandë dhe sipërfaqe e përbashkët/shkallë) në vlerën 80.000 euro, ku është parashikuar mënyra e likuidimit të çmimit të shitjes. Kjo kontratë është raportuar pranë organit kompetent sipas rregullave ligjore. Në DPV-në e vitit 2009 subjekti e ka deklaruar këtë kontratë, si dhe pjesën takuese prej 50%.

- Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar shpenzim për kompletimin e banesës në Selitë, Tiranë, në shumën 550.000 lekë, si dhe ka deklaruar dhënien e apartamentit me qira.

- Në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*, pasuria nuk ka qenë e regjistruar pasi apartamenti me sip. 140.8 m², pasuria me nr. ***, është blerë me kontratë përfundimtare shitblerjeje nr. ***, datë 19.9.2019, në vlerën 80.000 euro, paraqitur në përgjigje të pyetësorit standard. Në kartelën e pasurisë, në rubrikën “Përshkrimi i veçantë”, pasqyrohet sipërfaqe e përbashkët 2.1 m² dhe sipërfaqe verandë 23 m² (në total sipërfaqe 165.9 m²).

- FSHU-ja² ka konfirmuar në emër të z. Edmond Koloshi kontratën nr. ***, në instancën Tiranë. UKT-ja³ ka konfirmuar në emër të z. Edmond Koloshi kontratën nr. *** për objektin në adresën rruga “****”, Tiranë.

¹ Shihni aneksin nr. ***, ***, ***, *** dhe *** në dosjen e ILDKPKI-së.

² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.12.2021, shkresën nr. *** prot., datë 13.4.2021 të FSHU-së në dosjen e Komisionit.

³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 30.3.2021 dhe nr. *** prot., datë 23.11.2021, të UKT-së, në dosjen e Komisionit.

20.1.1. Sa më sipër nuk konstatohen problematika në lidhje me mënyrën e përfitimit të pasurisë dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit.

20.2. Në lidhje me mënyrën e likuidimit të çmimit, sipas dokumenteve të administruara nga ILDKPKI-ja, rezulton se:

- Sipas kontratës së porosisë çmimi i shitjes do të shlyhej në këtë mënyrë: (i) kësti i parë 10.000 euro me firmosjen e kontratës; (ii) kësti i dytë 50.000 euro me lëvrimin e kredisë pranë Bankës Popullore; (iii) kësti i fundit 20.000 euro me regjistrimin e apartamentit pranë ZVRPP-së. Kalimi i pronësisë do të bëhet me një kontratë të veçantë shitblerjeje.

- Sipas mandatpagesës datë 17.9.2009 rezulton të jetë paguar shuma 10.000 euro nga z. Edmond Koloshi. Sipas nxjerrjes së llogarisë së shoqërisë “****” sh.p.k. vërehet përkrahimi datë 12.10.2009, “5.728.000 lekë Edmond pagesë për blerje apartamenti”. Në DPV-në e vitit 2009 subjekti ka deklaruar shlyerjen e shumës 52.000 euro dhe gjendjen e detyrimit prej 28.000 euro.

- Sipas mandatpagesës datë 10.12.2014 është paguar shuma 2.000 euro nga z. Edmond Koloshi. Në DPV-në e vitit 2014 ka deklaruar shlyerjen e shumës 2.000 euro dhe gjendjen e detyrimit prej 26.000 euro.

- Sipas nxjerrjeve të llogarive të shoqërisë “****” sh.p.k. në datën 11.10.2016 vërehen përkrahimet: (i) Edmond Koloshi pagesë për blerje apartamenti tek *** në shumën 400.000 lekë; (ii) Edmond Koloshi pagesë për blerje apartamenti tek *** në shumën 700 euro. Në DPV-në e vitit 2016 ka deklaruar shlyerjen e detyrimit në shumat 700 euro dhe 400.000 lekë dhe gjendjen e detyrimit prej 22.400 euro.

- Në deklaratën *Vetting* subjekti e ka deklaruar shlyerjen e detyrimit ndaj shoqërisë në shumën 57.600 euro dhe detyrimin e mbetur prej 22.400 euro.

- Shoqëria “****” sh.p.k. ka konfirmuar pagesat si më sipër, si dhe ka konfirmuar se deri në datën 26.1.2017 janë likuiduar në total shumat 6.128.000 lekë dhe 12.700 euro dhe se detyrimi i mbetur është rreth 20.000 euro. Po kështu konfirmohet se më 15.3.2017 është paguar në bankë shuma 550.000 lekë.

- Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka shpjeguar gjithashtu mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes duke paraqitur dokumentet shkresore.

- Nga ekstrakti i llogarisë së subjektit pranë Raiffeisen Bank⁴, duket se nëpërmjet llogarisë në monedhat lekë dhe euro janë kryer në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. pagesat sipas deklaratimeve të subjektit deri në datën 15.3.2017, si dhe konfirmohen pagesat e mbetura deri në vitin 2019.

20.2.1. Për sa më sipër, nuk u konstatojnë problematika në mënyrën e likuidimit të çmimit të shitjes prej 80.000 euro dhe deklaratimet e subjektit, çmim i cili është likuiduar tërësisht në këtë mënyrë: (i) shuma 12.000 euro sipas mandatpagesave të depozituara nga subjekti respektivisht 10.000 euro, datë 17.9.2009 dhe 2.000 euro, datë 10.12.2014; (ii) shumat 8.958.150 lekë dhe 700 euro janë paguar gjatë periudhës 12.10.2009 – 9.9.2019, në total në favor të shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. nëpërmjet sistemit bankar. Në analizën financiare është verifikuar mundësia e kryerjes së pagesave në datat përkatëse deri në plotësimin e deklaratës *Vetting* (trajtuar në vijim).

20.3. Në lidhje me përdorimin/dhënien me qira të apartamentit nga aktet⁵ rezulton se:

- Në DPV-të e viteve 2012, 2013, 2014 dhe 2016, si dhe në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar dhënien e apartamentit me qira dhe të ardhurat e përfituara duke paraqitur edhe

⁴ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.3.2021 dhe nr. *** prot., datë 9.11.2021, të Raiffeisen Bank në dosjen e Komisionit.

⁵ Shihni aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

dokumentacion, ndërsa në përgjigje të pyetësorit standard ka sqaruar se gjatë periudhës 15.6.2015 – 15.4.2016 ka banuar vetë.

- Në pyetësorin standard, subjekti deklaroi se apartamenti është dhënë me qira gjatë periudhës 28.4.2012 – 30.9.2014 dhe më pas, gjatë periudhës 16.4.2016 – 16.12.2019, duke depozituar kontratat respektive të qirasë. Subjekti ka depozituar gjithashtu edhe vërtetime nga organet tatimore në lidhje me pagesat e tatimit mbi të ardhura nga qiratë e përfituara referuar këtyre kontratave.

- Në llogaritë bankare të subjektit në Raiffeisen Bank janë vërtetuar pagesa qiraje, si dhe pagimi i tatimit në burim për të ardhurat nga qiratë.

Në përfundim të hetimit administrativ, të ardhurat nga qiratë në shumat 18.700 euro dhe 946.374 lekë të kanalizuar nëpërmjet llogarisë bankare të subjektit në Raiffeisen Bank dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, janë konsideruar si të ardhura të ligjshme në analizën financiare në periudhat përkatëse.

20.4. Në lidhje me mobilimin e këtij apartamenti, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti deklaroi shpenzime për mobilim/pajisje elektroshtëpiake për të cilat nuk disponon fatura dhe më konkretisht: në vitin 2010 shpenzim në vlerën 100.000 lekë për mobiliet e kuzhinës; në vitin 2011 ka blerë pajisjet elektroshtëpiake dhe mobilje në vlerën 300.000 lekë; në vitin 2012 ka kryer shpenzime si mobilimi, blerje pajisjesh etj., në total në shumën 600.000 lekë; në vitin 2015 kompletim dhomë fëmijësh në shumën 100.000 lekë; shpenzime të tjera janë kryer në vitet 2019 – 2020. Shpenzimet e mësipërme të deklaruara nga subjekti gjatë hetimit administrativ, janë përfshirë në analizën financiare të viteve përkatëse.

20.5. Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, Komisioni ka analizuar në mënyrë specifike burimet: (i) hua e shlyer; (ii) kredi në Raiffeisen Bank; (iii) kursime, si vijon:

i) Për burimin “Hua e shlyer” nga aktet në dosje⁶, rezultoi se:

Në deklaratën *Vetting* subjekti ka paraqitur kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.9.2009, me huadhënës shtetasi A. E. dhe huamarrës Edmond Koloshi në shumën 10.000 euro për shlyerjen e këstit të parë për blerje apartamenti, për një afat 10-vjeçar, pa interes. Në DPV-në e vitit 2009 subjekti e ka deklaruar në të njëjtën mënyrë huan e marrë me këtë kontratë huaje dhe me të njëjtin destinacion. Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në vitin 2016, subjekti ka shpjeguar se në momentin e lidhjes së kontratës së porosisë ka paguar shumën 10.000 euro, të marrë hua *cash* prej shtetasit A. E., shok fëmijërie, i cili ka pasur të ardhura që kanë mundësuar dhënien e huas. Në përgjigje të pyetësorit standard ka paraqitur dokumente që vërtetojnë të ardhura të këtij shtetasi.

Nga ana e Komisionit është kërkuar informacion në lidhje me të ardhurat e ligjshme të huadhënësit dhe bashkëshortes së tij deri në momentin e dhënies së huas datë 5.9.2009. ISSH-ja⁷ konfirmoi pagesën e kontributeve mbi të ardhurat nga paga (net) të tyre. Bazuar në të ardhurat e dokumentuara të huadhënësit dhe bashkëshortes së tij, si dhe në shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së⁸, mundësia për kursim e huadhënësit dhe bashkëshortes së tij për periudhën 1.1.2009 – 5.9.2009, duke përfshirë dhënien e huas në shumën 10.000 euro, është 597.165 lekë. Referuar kësaj shume, si dhe në kushtet kur nuk u vërtetua që subjekti të ketë qenë në kushtet e një konflikti interesi me huadhënësin apo bashkëshorten e tij⁹, ndërkohë që Komisioni nuk ka pasur dyshime në lidhje me huan, e cila është deklaruar saktësisht nga subjekti dhe është vërtetuar në kohë reale me akt noterial, në analizën financiare huaja prej

⁶ Shihni aneksin nr. *** , *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.9.2023, të ISSH Drejtoria e Arkivit Qendror, Dega e Arkivit të Rajonit Tiranë, në dosjen e Komisionit.

⁸ Sipas informacionit të Regjistrimit të Gjendjes Civile 2008, familja E. përbëhet nga tre pjesëtarë, fëmija është lindur në vitin 12.6.2008.

⁹ Shihni shkesën nr. *** prot., datë 31.7.2023, të PGJSHPJP Lezhë; shkresën nr. *** prot., datë 13.7.2023, të PGJSHPJP-së; shkresën nr. *** prot., datë 20.7.2023, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

10.000 euro është konsideruar si një prej burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit objekt verifikimi.

Edhe sa i takon shlyerjes së huas, nëpërmjet deklarimeve të subjektit dhe akteve shkresore të administruara¹⁰ u vërtetua që subjekti ka kryer deklarime të sakta në lidhje me detyrimet financiare për shkak të huas dhe shlyerjes së saj. Po kështu, nga analiza financiare është vërtetuar mundësia e kursimeve të ligjshme për kthimin e shumës 9.000 euro në vitin 2013 dhe 1.000 euro në vitin 2014.

ii) Për burimin “Kredi në Raiffeisen Bank” në shumën 6.200.000 lekë, nga aktet¹¹ rezultoi se:

Raiffeisen Bank ka konfirmuar se shtetasi Edmond N. Koloshi ka marrë një kredi në shumën 6.200.000 lekë, në datën 12.10.2009 sipas kontratës së kredisë bankare dhe hipotekës me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.10.2009, me qëllim blerje shtëpie ku një pjesë e fondeve do të kalohen në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k. Sipas dokumentit nxjerrje llogarie në emër të subjektit shuma 6.200.000 lekë është disbursuar në datën 12.10.2009. Sipas dokumentit nxjerrje llogarie të shoqërisë “****” sh.p.k., vërehet veprimi me datë 12.10.2009 në shumën 5.728.000 lekë me përshkrim “Edmond pagesë për blerje apartamenti”, pagesë e cila është konfirmuar nga shoqëria me shkresë të datës 27.7.2017. Ky transaksion është raportuar pranë institucionit kompetent ligjor. Në këto kushte, përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat bankare.

iii) Në lidhje me burimin “Kursime”

Në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka sqaruar se pagesat e kryera në datën 10.12.2014 në shumën 2.000 euro dhe datën 11.10.2016 në shumat 700 euro dhe 400.000 lekë, kanë si burim kursime nga qiraja, të ardhura të ligjshme, të cilat u vërtetuan gjatë hetimit administrativ. Komisioni ka kryer analizën financiare për të verifikuar mundësitë për kursim dhe paguar këstet e blerjes së apartamentit në datat 10.12.2014 dhe 11.10.2016, duke konsideruar: (i) të ardhurat nga paga për subjektin dhe bashkëshorten e tij; (ii) të ardhura net nga qiratë; (iii) të ardhurat nga shitja e një automjeti në datën 29.9.2014 (trajtuar më poshtë); (iv) shpenzimet jetike sipas përbërjes familjare dhe shpenzimet e tjera të evidentuara gjatë procesit të hetimit, prej nga rezulton se subjekti ka pasur mundësi financiare, për shkak të rezultatit pozitiv respektivisht në shumat 448.955 lekë dhe 827.167 lekë.

Për gjithë sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ rezulton se subjekti ka kryer deklarime të sakta në deklaratën *Vetting*, dhe jo vetëm, në lidhje me pasurinë objekt verifikimi si dhe ka pasur burime të ligjshme financiare për të kryer pagesat deri në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*. Sa i takon pagesave pas plotësimit të deklaratës *Vetting* u konstatua se ato janë kryer në rrugë bankare dhe nga verifikimet duket se subjekti i ka justifikuar ato me burime të ligjshme nga pagat dhe qiratë e apartamentit objekt verifikimi.

20.7. Në lidhje me çmimin e blerjes së pasurisë u konstatua se:

- Gjatë hetimit administrativ, referuar udhëzimit nr. 1, datë 20.8.2008¹², “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2008”, për qytetin e Tiranës, u konstatua se çmimi i referencës për vitin 2009 për zonën *** (në rezultatet e hetimit ishte shënuar gabimisht zona ***) ku ndodhet apartamenti objekt verifikimi është 67.500 lekë/m². Referuar këtij çmimi, apartamenti i blerë do të kushtonte 140.8 m² x 67.500 m² = 9.504.000 lekë/68.890 euro. Vërehet se subjekti nuk e ka blerë pasurinë më lirë se çmimi i referencës.

¹⁰ Shihni aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. *** prot., datë 9.11.2021, të ILDKPKI-së në dosjen e Komisionit.

¹¹ Shihni aneksin nr. ***, ***, *** dhe *** në dosjen e ILDKPKI-së; shkresën nr. *** prot., datë 16.3.2021, të Raiffeisen Bank në dosjen e Komisionit.

¹² Udhëzimi nr. 1, datë 20.8.2008, i EKB-së për “Miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB” është në fuqi për vitin 2009.

Kjo përlllogaritje është bërë vetëm për sipërfaqen e apartamentit sipas certifikatës së pronësisë pa përfshirë sipërfaqet e tjera. Por, edhe nëse përlllogaritja do të bëhej sipas sipërfaqes totale 165.9 m² (duke përfshirë sipërfaqet e përbashkëta dhe verandën), çmimi do të ishte 11.198.250 lekë/81.170 euro (165.9 x 67.500 lekë/m²), pra me një diferencë të pakonsiderueshme prej 1170 euro.

- Në denoncimin e datës 14.11.2023 të shtetases E. Dh., paraqitur në ONM pas riçeljes së hetimit administrativ, pretendohet se subjekti i rivlerësimit ka blerë apartamentin në vitin 2009 pranë shoqërisë “****” sh.p.k., më lirë se blerësit e tjerë. Me kërkesë të Komisionit, shoqëria “****” sh.p.k. vuri në dispozicion 19 kontrata në të njëjtin kompleks banimi, nga të cilat u evidentua vetëm një kontratë që i përket një apartamenti të blerë në të njëjtën godinë dhe në të njëjtën periudhë me subjektin e rivlerësimit, konkretisht ajo e datës 29.6.2009, sipas së cilës çmimi i blerjes për metër katror (370 euro) është më i ulët se ai i apartamentit të subjektit (482.21 euro/m²). Për këtë arsye, me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ shtesë, subjektit iu kërkua të paraqesë kontrata të ngjashme për blerjen e apartamenteve në të njëjtën periudhë dhe në të njëjtën godinë.

- Në parashtrimet e tij, subjekti duke iu referuar regjistrin të gjendjes civile parashtron se të dyja shtetasat me gjeneralitetet e denoncueses, një në Korçë dhe një në Përmet, nuk rezultojnë të punësuar pranë institucionit që denoncuesja ka deklaruar. Subjekti deklaroi se përmbajtja e këtij *email*-i nuk ka asgjë të vërtetë, por është vetëm shpifje, ashtu siç rezultoi edhe për çështjen penale nr. ***, datë 13.12.2018, me qëllim dëmtimin e reputacionit të tij si prokuror posaçërisht në procesin e rivlerësimit. Sa i përket çmimit të apartamentit, subjekti argumenton se në momentin e dakordësimit paraprak të çmimit për blerjen e apartamentit, janë mbajtur parasysh sipërfaqja ndërtimore, faza e ndërtimit, kursi i euros 1 euro = 138 lekë, infrastruktura e zonës etj. Sipas subjektit, sipërfaqja totale ndërtimore prej 165.9 m² ka përfshirë edhe sipërfaqe verande prej 23 m², e cila përlllogaritet sa 50% e çmimit. Sipas tij, edhe nga hetimi administrativ ka rezultuar se çmimi i blerjes nuk është më i ulët se çmimi i referencës për vitin 2009, si dhe përbën çmim mesatar krahasuar me kontratat e tjera të lidhura në këtë kompleks banimi të administruara nga Komisioni. Subjekti deklaroi se nuk ka pasur dhe nuk ka konflikt interesi apo marrëdhënie që ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen e detyrës si prokuror. Në parashtrimet e tij, subjekti paraqiti 4 kontrata të lidhura me shoqërinë “****” sh.p.k.

- Gjatë procesit të vendimmarrjes, Komisioni mori në shqyrtim dhe analizoi të gjitha kontratat e lidhura nga shoqëria “****” sh.p.k. të administruara gjatë procesit të rivlerësimit dhe në asnjërin prej tyre nuk rezultoi çmimi 1.000 euro/m², sikurse kishte pretenduar denoncuesja.

- Po kështu, në një analizë tërësore të çmimit për metër katror të kontratave të administruara, i cili u konstatua të ishte i ndryshëm rast pas rasti edhe për kontrata të lidhura në të njëjtin vit, vlen të theksohet paraprakisht se çmimi për 1 m² nuk është një tregues mbi të cilin mund të arrihet në një përfundim të saktë në lidhje me një trajtim preferencial të mundshëm të subjektit. Është logjik dhe i aplikuar në praktikë fakti që çmimi i shitjes së apartamenteve në momentin e porositjes është më i lirë se çmimi i shitjes së një apartamenti të përfunduar në rastin kur palë shitëse është një shoqëri ndërtimore. Po kështu, në vijim të kësaj logjike Komisioni mban në konsideratë faktin që edhe pse kontratat e ngjashme të administruara janë të së njëjtës natyrë (kontrata porosie), ato janë lidhur në periudha dhe çmime të ndryshme për metër katror dhe për këtë shkak, nuk mund të merret i mirëqenë fakti se ato paraqesin të njëjtën gjendje faktike të apartamenteve me apartamentin e subjektit të rivlerësimit në momentin e porositjes. Në këto kushte, krahasimi direkt i çmimeve të kontratave bazuar vetëm me raportin e thjeshtë matematikor/çmim për metër katror, pa marrë në konsideratë elementet subjektive dhe objektive të marrëdhënieve kontraktuale, duhet konsideruar me rezervë dhe nuk mund të jetë kategorik.

- Përveç sa më sipër, bazuar në provat dhe rrethanat si vijojnë:

- i) në dy raste, një kontratë në vitin 2009 (për apartament në të njëjtën godinë) dhe një kontratë në vitin 2010 (për apartament në të njëjtin kompleks), çmimi i shitjes së apartamenteve ka qenë më i lirë se ai i blerë nga subjekti;
- ii) nëse çmimi për metër katror i verandës do të llogaritej me ½ e çmimit të shitjes, çmimi për 1 metër katror të apartamentit të subjektit do të ishte 521 euro/m², që është i përafërt me çmimin e disa prej kontratave të administruara (530 euro/m²);
- iii) subjekti nuk e ka blerë apartamentin në një çmim më të lirë se çmimet referencë sipas kostove të EKB-së;
- iv) subjekti nuk është gjendur në kushte të konfliktit të interesit me shoqërinë apo administratorin e saj,

në përfundim të procesit Komisioni nuk mund të arrijë në konkluzionin se subjekti e ka blerë pasurinë me një çmim favorizues.

21. Automjet tip “Audi A4”, vit prodhimi 2007, me targë *, blerë sipas faturës nr. ***, datë 30.9.2014, subjektit “****” sh.p.k., me NIPT ***. Burimi i financimit: shitja e automjetit me targë *** dhe kursime (bashkëlidhur janë certifikata e pronësisë, kontrata, fatura e shitjes, etj.). Vlera: 648.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika. Gjatë hetimit administrativ në lidhje me këtë mjet rezultoi se:**

21.1. Në lidhje me mënyrën e përfitimit nga aktet në dosje¹³ rezulton se, me kontratë shitblerjeje automjeti datë 30.9.2014 shoqëria “****” sh.p.k. i shet shtetasit Edmond Koloshi automjetin tip “Audi A4” në vlerën 648.000 lekë, sipas faturës tatimore të shitjes nr. ***, datë 30.9.2014, në çmimin 648.000 lekë. Sipas certifikatës së pronësisë datë 2.10.2014, automjeti me targë *** u regjistrua në emër të z. Edmond Koloshi¹⁴. Në DPV-në e vitit 2014 subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit, por pa deklaruar burimin, ndërsa në deklaratën *Vetting* dhe në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar si burim shitjen e automjetit me targë *** dhe kursime.

21.2. Në lidhje me automjetin me targë ***, u vërtetua se ky mjet është shitur në datën 29.9.2014 nga subjekti në çmimin 380.000 lekë, deklaruar në DPV-në e vitit 2014. Në DPV-në e vitit 2007 subjekti e ka deklaruar blerjen e tij në vlerën 600.000 lekë, por nuk ka deklaruar burimin. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka sqaruar se automjeti me targë *** është blerë me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.5.2007, të cilën e ka paraqitur bashkëlidhur në vlerën 600.000 lekë, me burim të ardhurat nga gjendja *cash* në fund të vitit 2006, të ardhurat nga pagat e tij, si dhe *overdraft* bankar në vlerën 200.000 lekë në Raiffeisen Bank datë 28.5.2007. Nga ekstrakti i llogarisë bankare të subjektit pranë Raiffeisen Bank, vërehet se sikurse subjekti deklaroi, në datën 28.5.2007 është tërhequr shuma 200.000 lekë.

21.3. Sa i takon gjendjes *cash*, në DPV-në e vitit 2006 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* 380.000 lekë¹⁵, ndërsa në DPV-në e vitit 2007 ka deklaruar gjendje *cash* 50.000 lekë. Pra, pavarësisht se subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2007 burimin e krijimit të mjetit të blerë në këtë vit, të cilin e ka deklaruar në pyetësorin standard dhe në atë nr. 2 (kursime *cash* + pagat + *overdraft*), nisur nga deklarimi i gjendjes *cash* në vitin 2007 me burim nga kursimet e vitit 2006, duket se shuma 330.000 lekë është shpenzuar për blerjen e këtij automjeti në datën 28.5.2007, krahas vlerës prej 200.000 lekësh të tërhequr po atë ditë në Raiffeisen Bank. Për më tepër, gjatë vitit 2007 nuk rezulton që subjekti të ketë blerë ndonjë pasuri tjetër.

¹³ Shihni aneksin nr. *** dhe *** në dosjen e ILDKPKI-së; shkresat nr. *** prot., datë 12.3.2021 dhe nr. *** prot., datë 10.11.2021, të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

¹⁴ Në DPV-në e vitit 2017 subjekti ka deklaruar shitjen e mjetit me kontratë të datës 14.8.2017.

¹⁵ Nga analiza financiare e vitit 2006, rezulton se subjekti ka pasur mundësi për të kursyer shumën *cash* prej 380.000 lekësh, për shkak të balancës pozitive prej 664.002 lekësh (pasqyruar në tabelën përmbledhëse të analizës financiare në fund të hetimit për kriterin e pasurisë).

21.4. Bazuar në të dhënat e administruara, Komisioni kreu analizën financiare paraqitur në tabelën si më poshtë, nga ku rezulton se subjekti ka pasur mundësi për të kursyer dhe blerë me të ardhura të ligjshme automjetin sipas kontratës së datës 28.5.2007, për shkak të balancës pozitive prej 265.975 lekësh.

Përshkrimi	2006	1.1.2007 – 28.5.2007
Pasuritë		-128,472
Automjet tip “Audi”, kontratë nr. ***, datë 28.5.2007		600,000
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>		-728,472
Likuiditete në bankë	342,309	-56,162
Gjendje <i>cash</i> sipas deklarimeve DPV	380,000	50,000
Gjendja e likuiditeteve	722,309	-6,162
Detyrime		0
		0
Pasuri net (pasuri – detyrime)		- 128,472
Të ardhurat		328,445
Të ardhurat nga paga subjekti		298,945
Të ardhurat nga paga bashkëshortja e subjektit		29,500
Shpenzimet		190,942
Shpenzime jetike		170,775
Shpenzime udhëtim vendi i punës		20,167
Mundësia për kursime		265,975

21.5. Si rrjedhojë, të ardhurat nga shitja e automjetit në datën 29.9.2014, në vlerën 380.000 lekë, janë konsideruar të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit objekt verifikimi. Sa i takon kursimeve të deklaruara në deklaratën *Vetting* si një burim tjetër, si të tilla janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat e siguruara nga subjekti dhe bashkëshortja e tij nga pagat për periudhën 1.1.2014 – 29.9.2014, në vlerën 1.604.587 lekë, si dhe të ardhura nga qiraja në shumën 714.714 lekë.

21.6. Në përfundim të hetimit administrativ është kryer analiza financiare për të verifikuar blerjen me të ardhura të ligjshme të automjetit në shumën 648.000 lekë, në datën 30.9.2014, paraqitur në tabelën si më poshtë, nga ku rezulton se subjekti ka pasur mundësi për kursim për shkak të balancës pozitive prej 53.056 lekësh.

Përshkrimi	2013	30.9.2014
Pasuritë		1,044,513
Automjet tip “Audi A4”, kontratë datë 30.9.2014		648,000
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>		355,834
Likuiditete në bankë	234,304	630,817
Gjendja <i>cash</i> sipas deklarimeve DPV	0	0
Gjendja e likuiditeteve	234,304	630,817
Detyrime		(232,249)
Kredi pranë Raiffeisen Bank blerje apartamenti		
<i>Pagesë principali</i>		-92,109
Marrë hua nga A. E.		
<i>Shlyer huaja A. E.</i>		-140,140
Pasuri net (pasuri – detyrime)		1,276,761
Të ardhurat		2,699,301
Të ardhurat nga paga subjekti		1,079,929
Të ardhurat nga paga bashkëshortja e subjektit		524,658
Të ardhura nga qiratë ap. “****” dhe ***		714,714
Të ardhura nga shitja e automjetit të blerë në vitin 2007		380,000
Shpenzimet		1,369,484
Shpenzime jetike		659,994
Shpenzime pagese interesi kredia RZB (2009)		324,068
Shpenzime tatim mbi qiratë		83,383
Shpenzime udhëtimi në vendin e punës		96,000
Shpenzime udhëtim TIMS		206,038
Mundësia për kursime		53,056

21.7. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me mosdeklarimin në DPV-në e vitit 2007 të burimit e krijimit të mjetit me targë ***, si dhe burimin e krijimit të mjetit objekt verifikimi në DPV-në e vitit 2014. Në parashtrimet e tij, subjekti ka dhënë sqarime duke iu referuar faktit që ai ka deklaruar të ardhurat që kanë shërbyer si burime, fakt i cili është i vërtetë. Në këto kushte dhe për sa kohë u vërtetua blerja e të dyja mjeteve me të ardhura të ligjshme, mosdeklarimi i burimit të tyre në DPV nuk çmohet si shkak për penalizim.

22. Në deklaratën Vetting subjekti ka deklaruar: “Kam në posedim apartament 1+1, me sip. rreth 50 m², rr. **”, p. ***, ap. ***, Tiranë, i cili është në proces legalizimi (shtesa) dhe një pjesë e tij (objekti ekzistues) që në vitin 1996 është në pronësi të babait tim N. K. si pjesë e pasurisë nr. ***, z. k. ***, Tiranë. Shënim: “shtesa” është ndërtuar me kontribute të përbashkëta familjare vit pas viti, që nga viti 1998 deri në vitin 2003. Burimi i financimit: kursime të familjes (bashkëlidhur: vetëdeklarimi pranë ALUIZNI-t, vërtetim datë 13.1.2015, librezat e OSHEE-së dhe UK Tiranë, certifikatë pronësie, deklaratë noteriale etj.). E pavlerësuar akoma zyrtarisht. Investimi në ndërtimin e “shtesës” është bërë me kontribute familjare rreth 400.000 lekë. Pjesa takuese: 50%”. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika.**

Hetimi i Komisionit

22.1. Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të kësaj pasurie nga aktet në dosje¹⁶ rezulton se:

- ASHK DV Tirana Jug konfirmon se shtetasi N. K. është pajisur me leje legalizimi, si dhe ka pasuri të regjistruara në emër të tij si vijojnë:

a. Apartamenti ekzistues me nr. pasurie ***, me sip. 70.25 m², blerë me bashkëshorten e tij me kontratë të datës 6.8.1996. Në DPDFD-në e vitit 2003 babai i subjektit N. K. ka deklaruar apartamentin me burim puna dhe kursimet familjare. Është vërtetuar lidhja e kontratave me OSHEE-në dhe UKT-në në emër të shtetasit N. K.

b. Apartamenti shtesë me nr. pasurie ***, me sip. 44.7 m², për të cilin rezultoi se:

- Sipas vetëdeklarimit nr. *** prot., datë 16.8.2006 rezulton objekt i përfunduar, shtesë anësore 5 kate e bërë nga subjekti ndërtues “****” F. Sh., me investitor banorët e çdo apartamenti të shk. ***, p. ***, sipas listës bashkëlidhur. Bashkëlidhur ndodhet lista e 11 personave fizikë, ndër to edhe shtetasit N. dhe Edmond Koloshi.

- Në DPDFD-në e vitit 2003 subjekti ka deklaruar banesën me vlerë 36 milionë lekë të vjetra, me burim “Unë dhe babai + nëna + qiraja”.

- Sipas certifikatës familjare datë 10.8.2006 përbërja familjare rezulton N., V., A. dhe R. K. Sipas vërtetimit të Njësisë Bashkiake nr. ***, datë 1.12.2011, vërtetohet ndryshimi i mbiemrit familjarisht nga N. K. në N. K. në vitin 2002.

- Sipas procesverbalit të verifikimit në terren datë 1.6.2015, rezulton sipërfaqja bazë 44.7 m², nr. i kateve ***, sipërfaqja e shtesës 223.5 m², ndarë në kate nga 44.7 m², i kualifikuar për legalizim me akt kualifikimi nr. ***, viti 2015.

- Me shkresën datë 25.8.2016 të ALUIZNI-t Tiranë 2 drejtuar shtetasit N. K. është kërkuar deklaratë noteriale nga z. Edmond Koloshi për tërheqje nga vetëdeklarimi, pasi nuk është bashkëpronar në apartamentin ekzistues.

- Sipas deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.9.2016, të shtetasve N. K. dhe Edmond Koloshi, rezulton se z. Edmond Koloshi deklaroi se është tërhequr nga procedura e

¹⁶ Shihni aneksin nr. *** dhe nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së; shkresën nr. *** prot., datë 17.3.2021, të ASHK DP dhe shkresën nr. *** prot., datë 1.4.2021, të ASHK DVTJ në dosjen e Komisionit.

vetëdeklarimit, pasi nuk është bashkëpronar në apartamentin ekzistues dhe është dakord që procedurat për legalizimin e shtesës së pallatit që ndodhet në Tiranë me adresë rruga “****”, p. ****, shk. ****, k. ****, ap. **** t’i vazhdojë babai i tij N. K.

- Sipas lejes së legalizimit nr. ****, datë 7.4.2017, shtesa e apartamentit në objektin ekzistues pesëkatësh figuron në emër të shtetasit N. K., me sip. 44.7 m². Po kështu, në kartelën e pasurisë, pasuria nr. ****, apartament me sip. 44.7 m², figuron në emër të shtetasit N. K. me datë regjistrimi 14.7.2017.

- Subjekti ka paraqitur librezë të OSHEE-së për kontratën nr. **** dhe librezë uji për kontratën nr. ****, të dyja me adresë rruga “****”, në emër të shtetasit N. K.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se shtesa anësore është ndërtuar si objekt ndërtimor (strukturë karabina) në fund të vitit 1998 dhe deri në fund të vitit 2002 janë bërë punime në rifinitura të brendshme, dyer, dritare, etj. Më pas, duke u lidhur me apartamentin ekzistues, e gjithë sipërfaqja e përfutur është organizuar në dy apartamente të pavarura nga njëra-tjetra dhe apartamenti i ri është vënë në shfrytëzim në vitin 2003. Ky deklaram i subjektit konfirmohet me verifikimin në sistemin *online* të ASIG-ut, ku duket se shtesa **** kate, pjesë e së cilës është edhe apartamenti objekt verifikimi, ekziston që në ortofoton e vitit 1999. Po kështu, referuar të dhënave të FSHU-së, çelja e kontratës së energjisë elektrike është me datë 20.4.2002, që do të thotë se në këtë datë apartamenti ka qenë i përfunduar. Për më tepër, pasuria është dhënë me qira që në vitin 2003, deklaruar nga subjekti në DPFD-në e vitit 2003.

22.2. Në lidhje me shpenzimet për mobilimin e apartamentit shtesë 1+1, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti deklaroi se apartamenti ka qenë i kompletuar me mobilje dhe pajisje elektrike modeste, përpara emërimit të tij si prokuror, pasi është dhënë me qira i kompletuar. Pas vitit 2003 janë kryer në vazhdimësi shpenzime modeste, për të cilat nuk disponon fatura, dhe më konkretisht: në vitin 2004, pajisje elektroshtëpiake në vlerën rreth 30.000 lekë; në vitin 2006 shpenzime për dhomë gjumi etj. Në vlerën rreth 100.000 lekë; në vitin 2007 ka ndërruar mobiliet e kuzhinës së bashku me pajisjet elektroshtëpiake në shumën 200.000 lekë; në vitin 2009 pajisje elektroshtëpiake në vlerën 50.000 lekë dhe në vitin 2015 mobilje në vlerën 70.000 lekë. Shpenzimet e deklaruara nga subjekti gjatë periudhës kur ka qenë në detyrë, janë përfshirë si shpenzime në analizën financiare të viteve përkatëse, për shkak se ai vetë ka pranuar që e ka përdorur këtë pasuri dhe e ka dhënë për disa muaj me qira.

22.3. Sa i takon deklarimit të kësaj pasurie, nga aktet e administruara, rezultojnë se:

- Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri si adresë banimi që në vitin 2003¹⁷ e në vijim, për vitet që ka banuar në të. Po kështu, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si adrese banimi adresën e kësaj pasurie dhe konform dispozitave ligjore ka plotësuar saktësisht formularin e deklarimit ku në rubrikën “Pasuri në përdorim” ka deklaruar posedimin/përdorimin e pasurisë në pronësi të babait të tij dhe burimet e krijimit të saj, duke paraqitur dokumentet shkresore provuese.

- Në përgjigje të pyetësorit standard ka sqaruar se nga data 1.10.2003 – 31.12.2003, ka banuar me babain dhe familjen në adresën: rruga “****”, p. nr. ****, ap. nr. ****, Tiranë, në apartamentin 2+1, në pronësi të babait të tij (apartamenti ekzistues). Në periudhën 1.1.2004 – 15.6.2015, së bashku me bashkëshorten dhe fëmijët ka banuar, në adresën: rruga “****”, p. nr. ****, ap. nr. ****, Tiranë (në apartamentin 1+1 shtesë), sistemi i ri i adresave – rr. “****”, nd. ****, h. ****, ap. ****, Njësia nr. ****, Tiranë, duke shpjeguar se ky apartament është 1+1 dhe është improvizuar, pasi përbëhet nga një pjesë e pronës ekzistuese (pasuri nr. ****) dhe një pjesë e shtesës (pasuri nr. ****), në pronësi të babait të tij. Subjekti deklaroi se në periudhën

¹⁷ Në këtë deklaratë ka deklaruar të ardhura nga dhënia me qira në shumën 3 milionë lekë/vit të vjetra. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se ky apartament i ri (1+1) shtesë, gjatë vitit 2003 është dhënë me qira nga babai i tij tek persona të tretë për një vlerë prej 25.000 lekë/muaj, për të cilat babai nuk ka derdhur tatimin në burim. Në mungesë të një dokumentacioni shkresor që vërteton dhënie me qira të këtij apartamenti dhe informacionit se nuk janë paguar detyrimet tatimore mbi qiratë e vjelura, këto të ardhura nuk janë konsideruar në analizën financiare të vitit 2003.

dhjetor 2015 – prill 2016 ky apartament është dhënë me qira duke paraqitur kontratën respektive të qirasë dhe vërtetime pagese të tatimit në burim mbi qiratë e përfituara. Nga ekstrakti i llogarisë bankare të subjektit vërtetohet kanalizimi i qirave për periudhën 2.9.2015 – 6.4.2016, si dhe pagesat e tatimit në burim. Gjithashtu, DRT-ja¹⁸ ka konfirmuar pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga qiratë. Si rrjedhojë, këto të ardhura nga qiraja janë konsideruar si të ardhura në analizën financiare të kësaj periudhe.

22.4. Bazuar në sa më sipër, u evidentua se: (i) apartamenti me nr. pasurie *** në pronësi të babait me bashkëshorten e tij (njerka e subjektit) është blerë me kontratë shitblerjeje në vitin 1996 kur subjekti ka qenë 18 vjeç; (ii) apartamenti me nr. pasurie *** (1+1, shtesë e apartamentit të mësipërm ekzistues), deklaruar ndër vite edhe në deklaratën *Vetting* si adresë banimi dhe pasuri në posedim nga ana e subjektit, është legalizuar në pronësi të babait të subjektit dhe është ndërtuar në periudhën 1998 – 2002 kur subjekti nuk ka qenë në detyrën e prokurorit (në vitin 2001 – 2002 ka qenë student në Shkollën e Magjistraturës).

22.5. Pavarësisht se nuk u vërtetuan kontribute të subjektit si prokuror apo për shkak të ndonjë funksioni tjetër, është kryer analiza financiare për pasurinë shtesë 1+1 e apartamentit ekzistues me të dhënat që disponohen. Si periudhë ndërtimi u konsiderua periudha 1.1.1998 (në mungesë të të dhënave sipas deklarimeve të subjektit) – 20.4.2002 (analizuar në paragrafin e fundit të shkronjës “b” më sipër).

22.6. Sa i takon vlerës së pasurisë apartament 1+1, në kushtet e deklarimeve të ndryshme të vlerës së pasurisë/kostos së ndërtimit dhe mungesës së të dhënave shkresore që vërtetojnë investime/punime në banesë, Komisioni ka kryer analizën financiare si në tabelën më poshtë duke përllogaritur si vlera të pasurisë: (i) koston e ndërtimit në vlerën 1.211.000 lekë sipas udhëzimeve të EKB-së; (ii) vlerën 3.600.000 lekë, deklaruar në DPFD-në e vitit 2003; (iii) koston e ndërtimit prej 400.000 lekësh, deklaruar në deklaratën *Vetting*, e cila ishte deklaruar edhe gjatë pyetjes pranë ILDKPKI-së në procesverbalin e datës 21.1.2016, ku subjekti ka deklaruar se vlera e vendosur në DPV-në e vitit 2003 ka qenë vlera e vlerësuar prej tij si vlerë tregu.

Përshkrimi	1992 – 20.4.2002	1992 – 20.4.2002	1992 – 20.4.2002
Pasuritë	4,057,000	4,057,000	4,057,000
Apartamenti i babait të subjektit, blerë në vitin 1996	3,207,000	3,207,000	3,207,000
Apartament në Kukës, blerë në vitin 1998 në emër të subjektit	850,000	850,000	850,000
Gjendja e likuiditeteve	0	0	0
Të ardhurat	2,739,493	2,739,493	2,739,493
Të ardhurat bursa e akorduar nga Shkolla e Magjistraturës	162,280	162,280	162,280
Të ardhura familjarët e subjektit	1,977,213	1,977,213	1,977,213
Të ardhura nga shitja ap. babai në Kukës	600,000	600,000	600,000
Shpenzimet	3,810,224.24	6,198,715	2,998,715
Shpenzime jetike	2,598,715	2,598,715	2,598,715
Shpenzime për punime të shtesës së ap. “****”	1,211,509	3,600,000	400,000
Mundësia për kursime	- 5,127,732	-7,516,222	-4,316,222

22.7. Në këtë analizë janë përllogaritur: të ardhurat e dokumentuara të subjektit nga Shkolla e Magjistraturës¹⁹; të ardhura të familjarëve të subjektit²⁰; të ardhura nga shitja e apartamentit të babait të subjektit në vitin 1996 në shumën 600.000 lekë; pasuri të verifikuara në emër të babait dhe subjektit të blera në vitet 1996 dhe 1998; shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së.

22.8. Në përfundim të hetimit administrativ, nga analiza financiare, e cila i përket periudhës përpara fillimit të detyrës si prokuror, duket që familja e origjinës së subjektit nuk ka pasur

¹⁸ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.3.2021 dhe nr. *** prot., datë 17.11.2021 të DRT-së Tiranë në dosjen e Komisionit dhe shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2016 në aneksin nr. *** të dosjes së ILDKPKI-së.

¹⁹ Shihni aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁰ Shihni dokumentacionin e depozituar nga subjekti në lidhje me të ardhurat e familjarëve të tij, në pyetësorin nr. 2 në dosjen e Komisionit.

mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për investimin e përlllogaritur në tri vlerat si më sipër. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime e dokumente shkresore në lidhje me këtë konstatim. Në parashtrimet e veta subjekti sqaroi se *ndërtimi nuk është kryer me kompani ndërtimi, e cila rregullisht deklaron taksat dhe tatimet, pagesë për truallin, sigurimet shoqërore të punëtorisë, pagesë projekti, ndikimin në infrastrukturë, deklaron fitimet, etj., të cilat përbëjnë koston e ndërtimit të përlllogaritur sipas EKB-së, por është kryer me kosto minimale, me cilësi të ulët materialesh, duke punësuar punëtorë ndërtimi dhe disa volume pune janë kryer me punë vullnetare. Në lidhje me vlerën 3.600.000 lekë të deklaruar në DPFĐ-në e vitit 2003, deklaron se ajo është vendosur nga ana e tij si vlerë tregu për këtë pasuri në vitin 2003 dhe jo si vlerë investimi të kryer për ndërtimin e kësaj shtese. Vlera e koston së ndërtimit prej 400.000 lekësh, e deklaruar nga ana e tij në vazhdimësi, është vlera e vërtetë që ka pasur ky investim. Kostoja e ndërtimit të shtesës së apartamentit në sipërfaqe prej (44.7 m²) në emër të shtetasit N. R. K., ka qenë në vlerën 300.000 lekë, të cilat janë paguar pjesë - pjesë në formë cash deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit. Kjo ka qenë kostoja standarde që kanë paguar të gjithë banorët e shkallës nr. ***, p. nr. ***. Në vijim është investuar edhe një shumë prej 100.000 lekësh për dyer, dritare, elektrike, hidraulike, etj. dhe vlera totale e ndërtimit ka arritur në 400.000 lekë. Kjo vlerë është deklaruar edhe përpara ILDKPKI-së, në vitin 2016.*

22.9. Sipas subjektit, gjatë periudhës 1995 – 1999 kur babai i tij ka qenë i papunë, ka ushtruar aktivitet privat, por i paregjistruar dhe është në pamundësi dokumentimi të këtyre të ardhurave. Gjithashtu, subjekti pretendon se një pasuri apartament i blerë nga babai i tij në vitin 1996, pa të drejtë është konsideruar nga Komisioni si shpenzim në analizën financiare që ka filluar që nga viti 1998.

22.10. Subjekti konkludon se nëse koston e ndërtimit do të konsideroheshin në shumën 400.000 lekë të shpërndarë gjatë viteve 1998 – 2002, diferenca në analizën financiare do të ishte minimale. Po kështu, thekson se meqenëse dhe nga hetimi administrativ nuk janë vërtetuar kontribute të tij si prokuror apo për shkak të ndonjë funksioni tjetër në investimin e pasurisë së deklaruar në posedim në deklaratën *Vetting* në pronësi të babait të tij, pamundësia e të ardhurave të ligjshme të familjes së origjinës, nuk ndikon në analizën financiare të tij, pasi ato janë krijuar përpara se ai të emërohej prokuror.

22.11. Në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni çmoi të konsiderojë të drejtë pretendimin e subjektit se vlera prej 3.600.000 lekësh e deklaruar në DPFĐ-në e vitit 2003, i është referuar një vlerë tregu të menduar prej tij në procesin e plotësimit të deklaratës. Kjo referuar faktit që si koston e ndërtimit (në vlerën 1.200.105 lekë) ashtu edhe ato të shitjes në tregun e lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës për vitin 2003 (në vlerën 2.389.215 lekë), janë më të ulëta se vlera 3.600.000 lekë e deklaruar, shumë që nisur nga një logjikë e thjeshtë, nuk mund të jetë vlerë e investuar për krijimin e pasurisë në atë kohë, por vlerë tregu e gjykuar nga subjekti. Për më tepër, ajo që ka shumë rëndësi është fakti se vlera e investimit është saktësuar më pas si në deklaratimet pranë ILDKPKI-së në vitin 2016, ashtu edhe në deklaratën *Vetting*, ku si kosto ndërtimi është deklaruar shuma 400.000 lekë. Referuar kësaj vlerë, Komisioni rishikoi analizën financiare, proces gjatë të cilit vlerësoi të bazuar pretendimin e subjektit se analiza financiare për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi duhet të fillojë nga viti 1998 kur ka filluar ndërtimi dhe jo nga viti 1992 sikurse ishte kryer në përfundim të hetimit administrativ. Duke qenë se si periudhë ndërtimi nga ana e Komisionit është konsideruar periudha 1998 – 2002, analiza e rishikuar në përfundim të procesit është bërë vetëm për këtë periudhë, duke u hequr të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e kryera deri në datën 31.12.1997 (ndër të tjera si shpenzim ishte përlllogaritur edhe vlera e një pasurie të blerë nga babai i subjektit prej 30.000 USD në vitin 1996). Në përfundim, balanca negative për periudhën 1998 – 20.4.2002 bëhet -1.578.584 lekë, ndërsa, nëse si vlerë investimi do të përlllogaritej vlera 1.211.509 lekë sipas kostove të EKB-së, balanca finale do të ishte -2.390.093 lekë.

22.12. Por, për të dyja këto balanca, në kushtet kur nuk është ngritur asnjë dyshim në lidhje me pasurinë apartament 1+1 në pronësi të babait të subjektit dhe në posedim të subjektit, Komisioni çmon se subjekti nuk mund të penalizohet për efekt të procesit të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit nr. 8/42016, për sa kohë që:

i) Në vitin 2002 kur ka përfunduar ndërtimi i shtesës ai nuk ka qenë as subjekt deklarues, as prokuror dhe asnjë në ndonjë funksion tjetër, pasi ka qenë student në Shkollën e Magjistraturës. Për më tepër, analiza financiare e Komisionit është një analizë me rezervë për sa kohë prindërit e subjektit nuk kanë qenë subjekte deklaruese dhe është kryer në mungesë të të dhënave të plota që do të mundësonin një analizë të mirëfilltë.

ii) Sipas ligjit, subjekti ka deklaruar rregullisht ndër vite dhe në deklaratën *Vetting* adresën e pasurisë si adresë banimi. Po kështu, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar posedimin/përdorimin e pasurisë dhe burimin e të ardhurave të përdorura për krijimin e saj.

23. Llogari bankare në Raiffeisen Bank (deri më 31.12.2016) në vlerat 220.229 lekë dhe 99 euro. Pjesa takuese: 100%. Burimi i financimit: të ardhura nga paga dhe qiratë (bashkëlidhur nxjerrja e llogarisë dhe vërtetim datë 19.1.2017). ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika. Gjatë hetimit, Raiffeisen Bank²¹ konfirmon se gjendja e llogarive bankare të subjektit në datën 31.12.2016 janë përkatësisht për llogarinë nr. *** në lekë, gjendje 220.229 lekë dhe për llogarinë nr. *** në euro, gjendje 93,06 euro. Konfirmohet deklarimi i subjektit për gjendjen e llogarisë në lekë, ndërkohë vërehet se ka mospërputhje midis gjendjes së deklaruar nga subjekti për llogarinë në euro (99 euro) me gjendjen e konstatuar nga Komisioni (93,06 euro), i cili mund të jetë lapsus.

24. Gjendje cash në vlerën 20.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i financimit: kursime. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika. Nga analiza financiare e vitit 2016 rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për mundësinë e kursimit të gjendjes *cash* prej 20.000 lekësh²².

25. Në rubrikën “Detyrime financiare” subjekti ka deklaruar:

25.1. Kontratë kredie bankare dhe hipoteke me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.10.2009, unë dhe bashkëshortja me “Raiffeisen Bank”, për ndërtimin e apartamentit në ***, Tiranë, për shumën 6.200.000 lekë, me afat kohor 25 vjet, me interes bazë “tribor” + 1.75% në vit. Sipas kontratës së kredisë, akteve dhe vërtetimit nr. ***, datë 20.1.2017, të Raiffeisen Bank (është shlyer principal 780.818 lekë dhe interes 3.537.821 lekë). Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer 5.419.181 lekë.

Nga aktet shkresore të administruara rezultoi se deklaratimet e subjektit janë të sakta dhe përputhen me të dhënat bankare²³. Konkretisht:

- Subjekti ka paraqitur vërtetimin datë 20.1.2017, nga Raiffeisen Bank, ku konfirmohet kredi hipotekore në datën 12.10.2009, në shumën 6.200.000 lekë. Principali i paguar: 780.818,88 lekë. Interesi i paguar: 3.537.821,62 lekë. Principali i mbetur: 5.419.181,12 lekë.

- Raiffeisen Bank ka konfirmuar se shtetasi Edmond N. Koloshi ka një kredi të marrë në shumën 6.200.000 lekë të marrë në datën 12.10.2009 dhe detyrimi i mbetur në datën 31.12.2016 është 5.419.181 lekë.

- Me kontratë kredie bankare dhe hipoteke nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.10.2009, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë marrë një kredi në shumën 6.200.000 lekë, në Raiffeisen Bank, me qëllim blerje shtëpie ku një pjesë e fondeve do të kalohen në llogari të shoqërisë “****”

²¹ Shihni shkresën kthim përgjigje të Raiffeisen Bank nr. *** prot., datë 9.11.2021 dhe nr. *** prot., datë 16.3.2021 në dosjen e Komisionit.

²² Rezultati i analizës financiare pasqyruar në tabelën përmbledhëse në fund të hetimit për kriterin e pasurisë.

²³ Shihni aneksin nr. ***, ***, në dosjen e ILDKPKI-së; shkresën nr. *** prot., datë 16.3.2021, të Raiffeisen Bank në dosjen e Komisionit.

sh.p.k. dhe si sigurim kredie është vendosur hipotekë mbi apartamentin nr. ***, në pronësi të babait të tij, trajtuar më lart.

- Sipas ekstraktit bankar, shuma 5.728.000 lekë është transferuar në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, në datën 12.10.2009, pas disbursimit të kredisë, me përshkrimin “Pagesë për blerje apartamenti”.

25.2. Kontratë për ndërtim apartamenti mes subjektit dhe bashkëshortes dhe kompanisë së ndërtimit “****” sh.p.k., në ***, Tiranë, me sip. 165.9 m², me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.9.2009. Sipas kontratës, akteve dhe vërtetimit nr. *** prot., datë 22.10.2016 të lëshuar nga shoqëria “****” sh.p.k. janë shlyer gjithsej 6.128.000 lekë + 12.700 euro = 57.600 euro. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer 22.400 euro. Nuk janë konstatuar problematika në lidhje me këtë detyrim financiar.

26. Personi i lidhur M. K. ka deklaruar pasuritë e deklaruara edhe nga bashkëshorti i saj, si dhe detyrimet financiare të deklaruara prej tij.

KONSTATIME TË TJERA

27. Sipas vërtetimit nr. ***, datë 24.1.2017, lëshuar nga ProCredit Bank²⁴, shtetasit M. K. dhe Edmond Koloshi kanë pasur llogari kursimi të hapur në datën 22.5.2004, e cila është mbyllur më 23.1.2017. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika. Gjatë hetimit administrativ në lidhje me këtë llogari rezultoi se:

27.1. ProCredit Bank ka konfirmuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij janë klientë të bankës, duke paraqitur dokumentacion dhe ekstrakte të llogarive përkatëse bankare, të cilat janë të mbyllura. Sipas të dhënave bankare, në llogaritë e përbashkëta të subjektit me bashkëshorten (në monedhat lekë dhe dollar) janë kryer depozitimet *cash* gjatë periudhës 2005 – 2007, për të cilat, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sqaron se janë kryer nga bashkëshortja e tij. Konkretisht sqaron se:

i) Depozitimet e kryera gjatë vitit 2005 kanë si burim gjendjen *cash* në fund të vitit 2004 (300.000 lekë), si dhe të ardhurat nga paga. Në fund të vitit 2005 gjendja e këtyre llogarive në ProCredit Bank ka qenë afërsisht 500.000 lekë (lekë dhe USD). Konkretisht, subjekti sqaron se: *“Në deklaratën periodike të vitit 2005 gabimisht nuk kam shkruar “llogari bankare në ProCredit”, por kam deklaruar si shprehje “para cash” në fund të vitit shumë 500.000 lekë, që në fakt është shuma totale e përafërt që ndodhej në llogaritë e ProCredit Bank. (Në të gjitha rastet e tjera si 2004, por edhe 2006 e vazhdim kam shkruar “llogari bankare ProCredit Bank”, por vetëm në vitin 2005 nuk e kam shkruar “llogari bankare”, por “para cash”. Pra edhe shprehja për këtë vit ka qenë “para cash” dhe jo si në rastet e tjera që për gjendjen fizike të gjendjes cash kam shkruar shprehjen “gjendje cash””.*

ii) Depozitimet e kryera në vitin 2006 kanë si burim tërheqjen e shumës 2.000 USD nga llogaria në dollar pranë ProCredit Bank dhe këmbimin në lekë të saj, si dhe të ardhurat e tërhequra nga paga e tij në Raiffeisen Bank.

iii) Depozitimet e kryera në vitin 2007 kanë si burim gjendjen *cash* në fund të vitit 2006 (380.000 lekë), një pjesë e të cilave janë depozituar në llogarinë e mësipërme në ProCredit Bank. Në fillim të vitit kjo llogari ka pasur shumë 242.124 lekë dhe në fund të vitit shumë 846 lekë, çka do të thotë se në fund të vitit ka pasur (-) 241.278 lekë më pak.

27.2. Për të verifikuar mundësinë financiare për krijimin e depozitave si më sipër, Komisioni i është referuar analizës financiare të viteve 2004, 2005, 2006 dhe 2007. Nisur nga deklarimi periodik në DPV-në e vitit 2005, ku subjekti ka deklaruar gjendje *cash* prej 500.000 lekësh, në përfundim të hetimit administrativ, deklarimet e subjektit në pyetësorin nr. 2 se shuma prej 500.000 lekësh e deklaruar “para cash” është gjendja e llogarive bankare në fund të vitit 2005

²⁴ Shihni aneksin nr. *** dhe nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresat nr. *** prot., datë 17.3.2021 dhe nr. *** prot., datë 18.11.2021, të ProCredit Bank, në dosjen e Komisionit.

dhe jo realisht *cash* në banesë, nuk është marrë në konsideratë. Për rrjedhojë, në analizën e vitit 2005 janë konsideruar si pasuri shuma 500.000 lekë e deklaruar si gjendje *cash* plus shuma 581.944 lekë gjendje në bankë. Kjo sjell si pasojë një balancë negative të këtij viti prej -532.093 lekësh, ndërsa analiza financiare e viteve 2004, 2006 dhe 2007 rezulton pozitive.

27.3. Pasi është njohur me këtë balancë negative, në parashtrimet e tij subjekti vijon të pretendojë, ashtu si edhe gjatë procesit të hetimit, se në DPV-në e vitit 2005 shprehja “para *cash*” është deklaruar gabimisht dhe kërkon që kjo të konsiderohet si një pasaktësi (subjekti i referohet nenit 24, paragrafi 2 i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003). Pra, sipas subjektit, shuma prej 500.000 lekësh ka qenë gjendje në llogaritë bankare në ProCredit Bank (50% me 50% me bashkëshorten), të cilën nuk e ka deklaruar si gjendje në llogaritë bankare, por e ka deklaruar si gjendje *cash*. Për të vërtetuar këtë, subjekti i referohet faktit që në fund të vitit 2005 gjendja e këtyre llogarive në ProCredit Bank ka qenë afërsisht 500.000 lekë (lekë + USD). Në këto kushte subjekti kërkon ndryshimin e analizës financiare të vitit 2005, duke mos konsideruar si pasuri vlerën 500.000 lekë si gjendje *cash*, por vetëm paratë e vendosura në llogaritë e përbashkëta në ProCredit Bank.

27.4. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, Komisioni çmoi se pavarësisht faktit që në fund të vitit 2005 gjendja e llogarive në ProCredit Bank ka qenë afërsisht 500.000 lekë (lekë + USD), kjo nuk do të thotë që subjekti nuk kishte edhe gjendje *cash* në banesë në vlerën e deklaruar në DPV-në e këtij viti. Po kështu, është e vërtetë që në të gjitha DPV-të (përveç asaj të vitit 2005) subjekti ka deklaruar gjendje *cash* për vitet që ka pasur kursime *cash* dhe “llogari bankare” për vitet që ka pasur kursime në bankë. Por, kjo nuk justifikon pretendimin e subjektit se ka gabuar në deklarim, për sa kohë në DPV-në e vitit 2005, e cila është një provë shkresore, ai ka shkruar shprehimisht “para *cash* 500.000 lekë” dhe sipas kësaj logjike, në këtë deklaratë subjekti gabimisht nuk ka deklaruar llogaritë bankare. Po kështu, në fund të vitit 2005 balanca e llogarive të subjektit në ProCredit Bank ka qenë në shumën 581.944 lekë (2.000 USD dhe 375.284 lekë), pra jo 500.000 lekë. Në këto kushte, ndonëse pretendimi i subjektit për një pasaktësi në deklarim mund të jetë i vërtetë, ai mbetet në nivel deklarativ dhe, si i tillë, nuk është marrë në konsideratë.

28. Në lidhje me llogarinë nr. ***, në lekë, në emër të shtetasës M. K., hapur në vitin 2013 pranë Credins Bank²⁵, me balancë 32 lekë në datën 26.1.2017, nga të dhënat bankare vërehet se që prej datës 5.7.2013 kanalizohet paga e bashkëshortes së subjektit. Kjo llogari dhe balanca e saj nuk është deklaruar në deklaratën *Vetting* nga bashkëshortja e subjektit dhe për herë të parë është deklaruar në DPV-në e vitit 2017. Gjithashtu, në deklaratat periodike vjetore të viteve 2009 – 2016, kur paga e bashkëshortes kanalizohet nëpërmjet sistemit bankar, llogaritë dhe balancat përkatëse në fund të periudhës raportuese nuk janë deklaruar nga ana e saj. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të japë sqarime, i cili në parashtrimet pranon pasaktësitë në deklarim, duke sqaruar se mosdeklarimi formal i llogarive bankare të pagës dhe balancave në fund të vitit nuk ka pasur si qëllim fshehjen e pasurisë dhe shmangien e kontrollit të pasurisë së bashkëshortes. Në përfundim të procesit, në kushtet kur ndër vite janë deklaruar saktësisht të ardhurat nga pagat e bashkëshortes, si dhe në kushtet kur balancat e llogarive të saj në fund të çdo viti janë në vlera të pakonsiderueshme, pasaktësia në deklarim çmohet formale dhe pa asnjë pasojë.

29. Nga të dhënat e RNSH-së rezultoi një prokurorë e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.8.2014²⁶, sipas së cilës shtetasit L. A. dhe A. A. i kanë dhënë subjektit në përdorim automjetin tip “Ford Fiesta”, me targë ***, për ta përdorur brenda dhe jashtë Shqipërisë pa afat të caktuar.

Ne lidhje me përdorimin e këtij mjeti rezultoi se:

²⁵ Shihni shkresat nr. *** prot., datë 19.11.2021 dhe nr. *** prot., datë 1.4.2021, në dosjen e Komisionit.

²⁶ Shihni shkresën datë 18.7.2023 të noterit B. V., në dosjen e Komisionit.

-Nga të dhënat në sistemin TIMS rezulton se subjekti ka vetëm një hyrje me këtë mjet në datën 19.8.2014.

-Nga verifikimi në sistemin AMF, sipas policës me datë 6.2.2014 – 5.2.2015 mjeti figuron në pronësi të shtetasit A. A., ndërsa subjekti i rivlerësimit nuk figuron përdorues i këtij mjeti. Pas datës 11.2.2016 mjeti nuk figuron më në pronësi të shtetasit A. A.

- Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se nga data 12.8.2014 deri më 19.8.2014 ai së bashku me familjen ka përdorur për një periudhë njëjavore automjetin tip “Ford Fiesta”, me targë ***, në pronësi të shtetasës L. A., me qëllim udhëtimin në Greqi për pushime verore, për shkak se mjeti i tij me targë *** ishte me defekt. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti konfirmoi se ky mjet është përdorur vetëm për shkakun dhe periudhën e deklaruar në përgjigje të pyetësorit standard dhe asnjë ditë më tepër. Pas verifikimeve nuk rezultoi konflikt interesi me shtetasit L. P. A. dhe A. Sh. A. apo përfshirje të tyre në veprimtari të kimit të organizuar²⁷.

- Sa më sipër, pavarësisht se nga të dhënat që disponoheshin në përfundim të hetimit, nuk vërtetohet që subjekti ta ketë poseduar/përdorur mjetin përveç sa ka deklaruar ai vetë, duke qenë se prokura e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.8.2014 është pa afat. Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkua të paraqesë sqarime e dokumente në lidhje me mosdeklarimin e përdorimit të mjetit sipas kësaj prokure në deklaratën *Vetting*.

- Subjekti parashtroi se mosdeklarimi në deklaratën *Vetting* ka qenë për shkak se ky automjet është përdorur vetëm për një periudhë njëjavore gjatë vitit 2014 dhe në kohën që është bërë deklarimi nuk ka qenë në përdorimin e tij. Sa i takon faktit që prokura ka qenë pa afat, sipas tij, kjo mund të ketë qenë për shkak të formës së gatshme të prokurës së posaçme që mund të ketë pasur noteri, që në fakt është realisht një praktikë e ndjekur nga noterët gjatë redaktimit të prokurave/kontratave të huapërdorjeve për lejimin e drejtimit të automjeteve. Sipas subjektit, pas periudhës së daljes dhe hyrjes me datë 12.8.2014 – 19.8.2014, automjeti i mësipërm i është kthyer shtetasës L. A. dhe nuk është përdorur në asnjë moment tjetër as nga ai dhe as nga bashkëshortja e tij dhe se i referohet faktit që në AMF nuk rezulton përdorues i këtij mjeti. Në mbështetje të pretendimeve të tij subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.10.2023, të shtetasve A. A. dhe L. A., të cilët pohojnë deklaratimet e subjektit.

Në përfundim të procesit, referuar të gjitha provave të administruara gjatë hetimit, si dhe duke vlerësuar pozitivisht faktin që në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar përdorimin njëjavor të mjetit, Komisioni i vlerësoi të argumentuara parashtimet e subjektit dhe nuk ka ngritur dyshime në lidhje me këtë automjet për të cilin nuk rezulton asnjë e dhënë direkte apo indirekte që në kohën e plotësimit të deklaratës *Vetting* të jetë përdorur nga subjekti apo bashkëshortja e tij.

30. ZVRPP Kukës²⁸ ka konfirmuar se z. Edmond Koloshi ka pasur të regjistruar pasurinë nr. ***, apartament me sip. 73.5 m², përfituar nga blerja dhe shitur nëpërmjet kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.3.2004. Gjatë hetimit administrativ në lidhje me këtë pasuri, u konstatua se:

30.1. Nga verifikimi i akteve në dosjen e ILDKPKI-së rezultoi se:

- Sipas kontratës së shitjes datë 30.4.1998, shtetasi B. M. i shet z. Edmond Koloshi një apartament në Kukës në vlerën 850.000 lekë.

- Sipas kontratës së shitblerjes me kusht kreditimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.3.2004, z. Edmond Koloshi i shet shtetasve S. S. (bashkëshorti i motrës) dhe V. S. (motra e subjektit) një apartament në Kukës me sip. 73.5 m² në vlerën prej 2.000.000 lekësh. Në kontratë është

²⁷ Shihni shkresat nr. *** prot., datë 31.7.2023, të PGJSHJPJ-së Lezhë; nr. *** prot., datë 13.7.2023, të PGJSHJPJ-së; nr. *** prot., datë 20.7.2023, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

²⁸ Shihni aneksin nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

parashikuar që pas pagesës së plotë të vlerës, shitësi do t'i kalojë blerësit pronësinë e apartamentit. Në të njëjtën kohë blerësi do të vendosë si garanci këtë apartament për llogari të Bankës së Kursimeve dhe ky apartament do të kalojë në pronësi të blerësve vetëm kur të shlyhet vlera totale e kredisë së marrë nga kjo bankë, prej 2.000.000 lekësh.

30.2. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se:

- Në vitin 2003 pasuria ka qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Pasi është lidhur kontrata me kusht kreditimi, në vitin 2004 pasuria është regjistruar në emër të motrës së subjektit V. S. dhe bashkëshortit të saj²⁹.

- Sipas dokumenteve të kredisë bankare³⁰ dhe dokumenteve që paraqiti subjekti në përgjigje të *email*-it datë 9.10.2023, të protokolluara në datën 10.10.2023, u vërtetua se në datën 15.3.2004, motra e subjektit është financuar me një hua në emër të saj dhe të bashkëshortit në shumën 2.000.000 lekë nga Banka e Kursimeve (sot Raiffeisen Bank), pasi është lidhur kontrata e shitjes me kusht kreditimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.12.2003, me palë shitëse subjektin dhe palë blerëse motrën e tij dhe bashkëshortin e saj. Po kështu konfirmohet se edhe pasuria objekt i kësaj kontrate, apartament me sip. 73.5 m² në Kukës, është ofruar si garanci për të siguruar këtë hua në bazë të kontratës së hipotekimit datë 15.3.2004 të nënshkruar nga vetë motra e subjekti me bashkëshortin e saj. Kredia është disbursuar në emër të shtetasit S. S. në datën 16.3.2004. Nuk ka të dhëna në lidhje me kalimin e çmimit të shitjes prej 2.000.000 lekësh në favor të subjektit në cilësinë e palës shitëse.

- Në datën 8.2.2010 është lëshuar deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.2.2010, nga përfaqësues të Raiffeisen Bank, sipas së cilës banka deklaron heqje dorë nga kjo pasuri pasi huamarrësit kanë kërkuar ndryshimin dhe zëvendësimin e kësaj garancie të ofruar për sigurimin e huas në këtë bankë.

- FSHU-ja nuk ka konfirmuar kontrata në emër të subjektit në instancën Kukës. Në përgjigje të pyetjes së dërguar me *email*-in e datës 10.10.2023 subjekti ka vërtetuar se kontrata e energjisë elektrike është lidhur në emër të blerësit të pasurisë A. D., si dhe një faturë tatimore të energjisë së muajit janar 2007 në emër të bashkëshortit të motrës së subjektit, S. S.

- U administruan akte të dosjes që i përkasin motrës së subjektit, znj. V. S. (K.), gjithashtu subjekt rivlerësimi, të dhënat e të cilave përpunohen me faktet dhe provat e administruara nga Komisioni dhe me deklaratimet e subjektit, që vërtetojnë kalimin e pronësisë së pasurisë të motra e subjektit në vitin 2004, si dhe faktin që pasuria është shitur prej saj dhe bashkëshortit të saj në vitin 2010.

- Gjatë hetimit është pyetur subjekti në lidhje me mosdeklarimet për këtë pasuri, burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit në vitin 1998 në çmimin 850.000 lekë, si dhe kohën e saktë dhe mënyrën e marrjes së shumës prej 2.000.000 lekësh, përfituar nga shitja e këtij apartamenti sipas kontratës së shitjes me kusht kreditimi. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti sqaron se *ky apartament është blerë në vitin 1998 nga babai i tij N. K. dhe, në dijeninë e tij, të ardhurat kanë si burim kursimet familjare, si dhe sendet me vlerë të trashëguar nga nëna e ndjerë e subjektit. Babai i tij vendosi ta regjistrojë këtë apartament formalisht në emrin e subjektit (atëherë 20 vjeç), por ai personalisht deklaroi se nuk e ka përdorur apo disponuar atë, pasi që nga viti 1996 e në vazhdim ka banuar në Tiranë. Kontrata e shitjes me kusht kreditimi në datë 8.12.2003, me nr. *** rep., nr. *** kol., është bërë në favor të motrës së tij*

²⁹ Shihni vërtetimin hipotekor të datës 6.4.2004, paraqitur nga subjekti në përgjigje të *email*-it dërguar nga Komisioni në datën 9.10.2023.

³⁰ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.10.2023, të Raiffeisen Bank në dosjen e Komisionit: (i) kontratë huaje dhe hipotekimi datë 15.3.2004; (ii) kontratë shitjeje me kusht kreditimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.12.2003; (iii) certifikatë pronësie e apartamentit me sip. 73.5 m², datë 8.12.2003, në emër të shtetasit Edmond N. Koloshi; (iv) plan pagesa e huas; (v) kërkesë për shlyerje para afati të huas me vulë datë 11.12.2020; (vi) nuk ka bashkëngjitur ekstrakt bankar apo dokumentacion tjetër bankar, për të verifikuar në lidhje me destinacionin e huas së marrë nga motra e subjektit.

V. dhe bashkëshortit të saj, të cilët do të merrnin kredi si të pastrehë. Pas këtij momenti nuk është lidhur asnjë kontratë apo deklaratë noteriale në emrin e tij për këtë pasuri. Pronësia ka kaluar në emër të blerësve të cilët më tej e kanë regjistruar këtë pasuri si dhe e kanë vendosur në hipotekë për bankën huadhënëse. Kjo pasuri nuk ka qenë në pronësinë e tij jo vetëm realisht por as formalisht në datën 31.12.2003, dhe si të tillë nuk është deklaruar në DPFĐ-në e vitit 2003, pasi nuk e dispononte më as formalisht. Kjo pasuri ishte blerë pesë vite përpara se ai të fillonte punën si prokuror në stazh, pra pa kontribute të tij, dhe nëse do të kishte përfutur ndonjë të ardhur nga shitja e saj, ai do ta deklaronte. Kalimi i pronësisë së apartamentit në favor të motrës ka qenë marrëdhënie midis babait dhe motrës së tij, të cilët kanë rënë dakord midis tyre për këtë fakt dhe nuk ka dijeni në lidhje me pagesën ose jo të çmimit të apartamentit.

Për të mbështetur deklaratimet e tij subjekti ka paraqitur kopje të noterizuar të kontratës së shitblerjes me kusht kreditimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.12.2003. Siç vërehet, kontrata e paraqitur nga subjekti me kusht kreditimi e vitit 2003 (që është e njëjtë me kontratën që ndodhet në bankë) ka të njëjtat ekstremite dhe përmbajtje me kontratën e datës 8.3.2004, administruar nga ILDKPKI-ja. Nga ana tjetër, subjekti nuk mohon që të ketë lidhur një kontratë me kusht kreditimi, porse deklaron se pasuria ka qenë blerë nga babai i tij në vitin 1998, i cili vendosi që ta regjistrojë këtë apartament formalisht në emrin e tij kur ishte 20 vjeç, dhe se në vijim, të gjitha veprimet janë kryer për shkak të marrëdhënies babë e bijë, me qëllim përfitimin e një kredie të butë nga motra e tij.

30.3. Ne përfundim të hetimit administrativ Komisioni çmoi si vijon:

- Sa i takon kontratës me kusht kreditimi që mban datën 8.3.2004, e cila është regjistruar në ZVRPP-në Kukës, duket që lidhja e saj është bërë për efekt të regjistrimit të pasurisë dhe shmangies së penaltetit nga ana e blerësve (për shkak të kalimit të afatit njëmuor të regjistrimit të kontratës së vitit 2003). Në këto kushte, dhe për sa kohë që kjo kontratë është tërësisht e njëjtë në formë dhe përmbajtje me kontratën e datës 8.3.2003 që është pjesë e dosjes së kredisë, Komisioni nuk ka ngritur dyshime, duke e vlerësuar pa ndonjë pasojë për subjektin e rivlerësimit.

- Sa i takon analizës financiare, blerja e kësaj pasurie në vitin 1998 është përfshirë në analizën financiare të këtij viti, që përkon me periudhën para se subjekti të jetë në detyrë dhe ka jetuar së bashku me familjen. Ndërsa, pavarësisht se subjekti nuk pretendoi përfitime nga shitja e kësaj pasurie, në kushtet kur nuk ka pasur të dhëna në lidhje me destinacionin e shumës së disbursuar prej 2.000.000 lekësh pas marrjes së kredisë nga motra e subjektit, të ardhurat nga shitja e saj janë përfshirë si të ardhura në analizën financiare të njoftuar me rezultatet e hetimit administrativ.

- Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të paraqesë sqarime e dokumente në lidhje me këto konstatime, duket se: (i) në vitin 2003 subjekti e ka pasur në pronësi pasurinë e blerë me kontratën nr. ***30.4.1998, të cilën nuk e ka deklaruar atë në DPFĐ-në e vitit 2003; (ii) në deklaratën për vitin 2004, kur subjekti ka humbur pronësinë pasi pasuria është regjistruar në emër të motrës dhe bashkëshortit të saj, subjekti mungon të ketë kryer deklaratime në lidhje me shitjen e kësaj pasurie; (iii) është i paqartë destinacioni i shumës 2.000.000 lekë, përfutur nga shitja e pasurisë, shumë e cila nuk është deklaruar si e ardhur në DPV-në e vitit 2004.

30.4. Në parashtrimet e tij, subjekti vijon të deklarojë ashtu si edhe gjatë hetimit administrativ se në fund të vitit 2003, që është edhe viti i plotësimit të deklaratës para fillimit të detyrës, ai nuk ka qenë pronar i pasurisë, duke iu referuar faktit se ai e kishte humbur pronësinë me lidhjen e kontratës në datën 8.12.2003 (subjekti i referohet neneve 4, 9 e vijues të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003). Po kështu këmbëngul se blerja e pasurisë ka qenë për shkak të vullnetit të babait të tij, ndërsa shitja si pasojë e marrëdhënieve babë e bijë me të motrën. Në këto kushte, edhe për sa i përket të ardhurës në vlerën e çmimit të shitjes së pasurisë prej 2.000.000 lekësh, subjekti vijon të pretendojë se nuk ka përfutur asnjë të ardhur nga shitja e pasurisë dhe kërkon heqjen e kësaj shume si të ardhur nga analiza financiare e vitit 2004.

30.5. Në përfundim të procesit u vlerësua se, kontrata që subjekti i referohet, ajo me datë 31.12.2003, është kontratë shitjeje me kusht kreditimi dhe subjekti nuk e kishte humbur pronësinë *de jure* në këtë vit, gjë që ka ndodhur në vitin 2004 kur u plotësua kushti (blerësit u kredituan në shumën 2.000.000 lekë) dhe pasuria u regjistrua në emër të motrës dhe bashkëshortit të saj. Në këto rrethana, subjekti duhet të kishte deklaruar pasurinë në DPDFD-në e vitit 2003 dhe në DPV-në e vitit 2004 shitjen e saj. Por, në kushtet kur u vërtetua që pasuria është përfituar në vitin 1998 kur subjekti ka qenë 20 vjeç, bëhen të besueshme deklaratimet e tij që pasuria është blerë *de facto* nga babai i tij dhe vetëm formalisht ai ka qenë blerës dhe shitës i kësaj pasurie. Po kështu, për shkak të marrëdhënieve familjare prind-fëmijë dhe kushteve në të cilat ndodheshin subjekti dhe motra e tij, bëhet i besueshëm dhe tërësisht logjik e i legjitimuar vullneti i babait të subjektit për ndarjen e dy pasurive, duke i lënë vajzës apartamentin në Kukës, që në atë periudhë ushtronte detyrën e gjyqtarës në Kukës dhe kishte aplikuar për kredi si e pastrehë, ndërsa djalit të vetëm shtesën 1+1 në Tiranë (ku subjekti ka banuar, trajtuar më lart), për shkak se ai gjatë kësaj periudhe ushtronte detyrën në Tiranë. Për më tepër, subjekti që deri në vitin 2003 ka qenë pronar *de jure* i pasurisë, nuk ka pasur asnjë arsye që të mos e deklaronte pasurinë në DPDFD-në e vitit 2003 apo shitjen e saj në vitin 2004.

30.6. Sa i takon çmimit prej 2.000.000 lekësh të parashikuar në kontratën e shitjes me kusht kreditimi të vitit 2003, referuar fakteve: (i) subjekti nuk ka kryer asnjë deklaram në asnjë prej DPV-ve apo deklaratën *Vetting* në lidhje me të ardhurën prej 2.000.000 lekësh; (ii) nuk e ka pretenduar/deklaruar dhe nuk e ka përdorur atë si burim për krijimin e ndonjë pasurie – pretendimi i subjektit se kjo shumë nuk është përfituar prej tij gjendet i bazuar, e për rrjedhojë, nuk u konsiderua si e ardhur e tij në analizën financiare përfundimtare të vitit 2004, e cila nuk rezulton me balancë negative edhe pas heqjes së kësaj shume.

30.7. Bazuar në sa më sipër, në një analizë logjike e harmonike të të gjitha rrethanave dhe provave të administruara, mosdeklarimet e subjektit në DPDFD-në e vitit 2003 dhe në DPV-në e vitit 2004 sa i takon apartamentit të banimit në Kukës, konsiderohen pasaktësi pa pasoja pikërisht për shkak të mungesës së dyshimeve apo edhe çdo të dhëne tjetër direkte a indirekte që mungesa e deklarimeve të jetë me një përfitim të caktuar nga ana e subjektit.

31. Në DPV-në e vitit 2003 subjekti ka deklaruar një automjet me vlerë 3.5 milionë lekë (të vjetra), pjesa takuese 100%, me burim krijimi nga puna. Ndërsa në DPV-në e vitit 2004 ka deklaruar të ardhura në shumën 350.000 lekë nga shitja e mjetit shtetasit J. V. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

31.1. I është kërkuar subjektit informacion për blerjen dhe shitjen e mjetit, duke paraqitur edhe dokumente shkresore. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti sqaron se automjeti tip “Volkswagen Golf 2”, me targë *** është blerë në vitin 2003, por kontrata e shitblerjes nuk është regjistruar në DRSHTRR dhe si i tillë nuk është regjistruar kalimi i pronësisë në emrin e tij. Më pas, gjatë vitit 2004, duke qenë se ky automjet kishte disa probleme teknike që në blerje, në marrëveshje me shitësin u vendos që të revokohej kontrata e shitblerjes me të dhe t’i shitej nga pronari i parë një shtetasi me emrin J. V., i cili më pas duhet ta ketë regjistruar në DRSHTRR. Pra, sipas subjektit automjeti nuk ka qenë asnjëherë i regjistruar në emrin e tij në DPSHTRR (edhe në informacionin e vënë në dispozicion të Komisionit, ky institucion nuk ka të dhëna për pronësinë e subjektit mbi këtë mjet). Subjekti deklaroi se nuk disponon kontratën noteriale të blerjes së mjetit, por as aktin e revokimit të saj, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, por edhe faktin se kjo blerje u revokua dhe palët u kthyen në gjendjen e mëparshme.

31.2. Në përfundim të hetimit, në mungesë të dokumentacionit provues, Komisioni iu referua deklarimeve të vitit 2003 ku është deklaruar blerja e mjetit, dhe vitit 2004 ku është deklaruar shitja e tij. Në analizën financiare për vitin 2003 blerja e mjetit është konsideruar si shpenzim në vlerën 350.000 lekë pas fillimit të detyrës 1.10.2003, ndërsa në vitin 2004, kjo shumë është konsideruar si e ardhur nga shitja.

31.3. Edhe në parashtrimet e tij, pasi iu kërkua përsëri që të dokumentojë blerjen dhe shitjen e mjetit, subjekti paraqiti të njëjtat deklaratime, duke vënë përsëri në dukje se është në pamundësi për të siguruar dokumente që vërtetojnë blerjen e mjetit në vitin 2003, revokimin e kontratës së këtij viti, si dhe shitjen e mjetit te shtetasi J. V. Po kështu, subjekti pranon përfshirjen si shpenzim të blerjes së mjetit në vitin 2003 në analizën financiare, por thekson se ky automjet është blerë para datës 15.10.2003 (kohë kur është emëruar prokuror në stazh në Prokurorinë e Rrethit Lezhë) dhe jo pas kësaj date, sikurse ishte përlogaritur nga Komisioni.

31.4. Pavarësisht se ky pretendim mbetet deklarativ, në vlerësimin përfundimtar të çështjes, Komisioni vlerësoi se në mungesë të një akti që vërteton periudhën e saktë të blerjes së mjetit (datë, muaj, vit), edhe konsiderimi i blerjes pas datës 1.10.2003 që subjekti ka filluar detyrën, është i pambështetur në ndonjë provë. Në këto rrethana, u vlerësua që për të vërtetuar mundësitë financiare për blerjen e mjetit, në përfundim të procesit Komisioni t'i referohet gjithë vitit 2003. Në analizën e rishikuar të këtij viti, nga ana e Komisionit u shtuan edhe të ardhurat e përfituara nga pensioni i babait të tij në shumën 93.901 lekë të përfituara në periudhën 1.6.2003 – 31.12.2003, të dokumentuara nga subjekti me dërgimin e parashtrimeve pas kalimit të barrës së provës, si dhe u krye rishikimi i të ardhurave të subjektit nga punësimi në Prokurorinë e Rrethit Lezhë për vitin 2003 sipas vërtetimeve të lëshuara nga ky institucion, paraqitur nga subjekti në parashtrime. Sipas këtyre vërtetimeve, këto të ardhura kanë qenë në vlerën 187.974 lekë, ndërkohë që në analizën e kryer në përfundim të hetimit, ishin përlogaritur në vlerën 125.613 lekë. Për sa i përket të ardhurës së përfituar nga gjyshja si shpërblim mujor si veterane luftime të pretenduar nga subjekti, në vërtetimin e ISSH-së nr. ***, datë 2.10.2023, cilësohet se gjyshja e subjektit ka përfituar të ardhur si shpërblim mujor shumë prej 37.830 lekësh, por nuk është specifikuar periudha kur është përfituar kjo e ardhur, ndaj dhe nuk është përfshirë në analizën financiare të periudhës deri në fund të vitit 2003 kur subjekti deklaroi se ka jetuar me familjen origjinë. Pas këtyre ndryshimeve, balanca negative në analizën financiare finale të vitit 2003 bëhet -344.722 lekë.

32. Nga të dhënat e administruara rezultuan 10 akte noteriale të noterës A. M. të raportuara nga kjo notere, ku vërehej se gjatë raportimit ishte shënuar emri dhe mbiemri i bashkëshortes së subjektit në cilësinë e porositëses. Nga ana e Komisionit u kryen disa verifikime të pasqyruara në menyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, në përfundim të të cilave u vërtetua se ka qenë një lapsus i noterës gjatë raportimit të akteve noteriale në të cilat bashkëshortja e subjektit nuk rezultoi të ketë qenë palë pjesëmarrëse.

Analiza financiare

33. Për të verifikuar justifikimin e pasurive të deklaruara në deklaratën *Vetting*, të krijuara gjatë periudhës 1.10.2003 – 31.12.2016, në përfundim të hetimit administrativ është kryer analiza financiare bazuar në vlerën e pasurive, të ardhurat dhe shpenzimet në vitet përkatëse, sipas së cilës totali i balancës negative ndër vite ishte në vlerën -1.005.329 lekë. Në parashtrimet e tij, subjekti e ka kundërshtuar këtë balancë negative, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

- Subjekti kundërshtoi analizën financiare të vitit 2005, duke pretenduar që si pasuri e këtij viti të konsiderohen vetëm likuiditetet në bankë prej 581.944 lekësh, të cilat gabimisht ishin konsideruar si para *cash*. Sikurse është trajtuar në paragrafin 27 të këtij vendimi, ky pretendim nuk u mor në konsideratë.

- Subjekti pretendon të ardhura më të larta se ato të përlogaritura nga Komisioni nga punësimi në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë në vitet 2003, 2004 dhe 2005, vërtetuar me vërtetimet nr. *** prot., datë 22.2.2021 dhe nr. *** prot., datë 19.1.2021, të cilat pasqyrojnë të ardhurat për të gjitha vitet deri në vitin 2016. Duke qenë se në këto vite të ardhurat nuk kalonin përmes bankës, në analizën financiare të rishikuar janë përfshirë si të ardhura të ligjshme vlerat sipas dy vërtetimeve të sipërpërmendura. Ndërsa për periudhën pas vitit 2005, Komisioni i është referuar vetëm pagave të kanalizuar përmes sistemit bankar të

evidentuara gjatë hetimit administrativ. Gjithashtu, në vërtetimin e datës 22.1.2021 rezultoi se shuma prej 280.000 lekësh ishte përfituar në vitin 2013 si bonus karburanti. Duke qenë se gjatë hetimit nuk ka pasur një të dhënë të tillë specifike, kjo shumë ishte konsideruar si e ardhur gjatë këtij viti. Me rishikimin e analizës financiare, bonusi i dhënë për karburant me qëllim shpenzimin e tij, u hoq nga totali i të ardhurave të vitit 2013, fakt që nuk çon në një balancë negative të këtij viti.

- Subjekti pretendon të ardhura nga pensionet e babait edhe për 6-mujorin e dytë të vitit 2003 dhe paraqiti vërtetim nga ISSH Tiranë me nr. ***, datë 2.10.2023, i cili vërteton këtë pretendim. Si rrjedhim, këto të ardhura u përfshinë tek të ardhurat e ligjshme në analizën financiare të rishikuar.

- Subjekti pretendon se mjeti i deklaruar në DPV-në e vitit 2003 në vlerën 350.000 lekë duhet të konsiderohet i blerë para datës 1.10.2003. Sikurse u analizua në paragrafin 31 në përfundim të procesit, vlera e këtij mjeti u konsiderua si shpenzim për vitin 2003.

- Subjekti pretendon se të ardhurat nga shitja e apartamentit në Kukës në vitin 2004, nuk duhen përfshirë në analizën financiare, pretendim i cili u konsiderua i bazuar.

Veç sa më sipër, në përfundim të procesit Komisioni evidentoi se në analizën financiare të dërguar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ, ishte bërë një gabim në përlogaritjen e të ardhurave të bashkëshortes së subjektit nga pagat në periudhën 2007 – 2016. Me rishikimin e analizës financiare, u verifikuan të ardhurat nga pagat e bashkëshortes dhe u bënë korrigjimet përkatëse. Në përfundim, rezultati i këtyre viteve ndryshon, sikurse është paraqitur edhe në tabelën më poshtë, por balanca e këtyre viteve nuk bëhet negative.

Në përfundim të procesit, nga analiza financiare e rishikuar pas marrjes në konsideratë të disa prej pretendimeve të subjektit, rezultoi se pamundësia financiare totale bëhet 773.270 lekë, balancë e cila në vlerësimin tërësor të çështjes nuk u konsiderua penalizuese.

Analiza financiare per subjektin Edmond Koloshi

PERSHKRIMI	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
Pasurite	550,000	115,124	766,819	-359,634	-20,025	-60,806	7,053,103	-7,435	48,846	27,253	178,659	1,012,731	-128,476	578,565	9,480,541
Apartament tek **** kontrata dt 12.10.2009							7,107,600					280,280		494,661	7,882,541
Automjet audi A4 kontr dt 30.09.2014												648,000			648,000
Automjet audi kontr 4299/1147 dt 28.05.2007					600,000										600,000
Apartament ne posedim 50m2 rr **** Tirane															0
Automjet i ble re ne v 2003 (dekl DPV 2003)	350,000														350,000
<i>Shitesa /paksimë likuiditeteve</i>	200,000	115,124	766,819	-359,634	-620,025	-60,806	-54,497	-7,435	48,846	27,253	178,659	84,451	-128,476	83,904	
Likuiditete ne Banka	0	15,124	581,944	342,309	52,284	1,478	-13,019	-20,454	28,392	55,645	234,304	318,755	170,279	234,184	0
Gjendje Cash deklaruar DPV	200,000	300,000	500,000	380,000	50,000	40,000	0	0	0	0	0	0	20,000	40,000	
Gjendja e likuiditeteve (bank + cash)	200,000	315,124	1,081,944	722,309	102,284	41,478	-13,019	-20,454	28,392	55,645	234,304	318,755	190,279	274,184	
Detyrime							7,558,334	(52,119)	(64,934)	(74,228)	(1,353,845)	(269,116)	(164,025)	(183,226)	5,396,841
Kredi prane Raiffeisen Bank bleje apartamenti							6,200,000								6,200,000
<i>Pagese Principali</i>							-21,266	-52,119	-64,934	-74,228	-92,045	-128,976	-164,025	-183,226	-780,819
Huaja A. E.							1,379,600								1,379,600
<i>Shlyer huaja A. E.</i>											-1,261,800	-140,140			-1,401,940
Pasuri net (Pasuri - Detyrime)	550,000	115,124.46	766,819.11	(359,634.28)	(20,025.03)	(60,806.36)	(505,231.16)	44,684.15	113,780.27	101,480.96	1,532,504.36	1,281,846.80	35,549.02	761,791.40	4,083,699.88
Te ardhurat	808,662	1,269,847	853,193	878,239	1,093,493	966,379	1,277,008	1,707,772	1,942,575	2,088,008	3,181,808	3,164,288	2,089,552	2,756,147	24,076,972
Te ardhurat nga paga subjekti & Shk Magjistratures	427,394	919,847	853,193	878,239	944,993	846,531	858,705	1,093,913	1,376,052	1,213,300	1,204,405	1,481,930	1,262,184	1,293,470	14,654,156
Te ardhurat nga paga b/sh subjektit		-	-	-	148,500	119,848	418,303	613,859	566,523	554,349	571,197	706,763	708,968	442,485	4,850,796
Te ardhurat e familjareve (b/jetese deri 31.12.2003)	381,268														381,268
Te ardhura nga qirate										320,359	1,406,206	595,595	118,400	1,020,193	3,460,753
Te ardhura nga shitja aut audit kontr dt 29.09.2014 (**** /****)												380,000			380,000
Te ardhura nga shitje njeti ne vitin 2004 (DPV 2004)		350,000													350,000
Shpenzimet	603,384	391,198	514,922	573,871	834,722	552,200	1,426,565	1,465,130	1,529,034	1,899,411	1,316,764	1,434,013	1,215,827	1,730,818	15,487,859
Shpenzime jetike	563,784	205,998	328,671	328,671	409,860	455,400	546,480	546,480	546,480	546,480	546,480	558,192	599,352	940,368	7,122,696
Shpenzime pagese interesi kredia RZB (2009)							101,705	676,360	615,557	595,365	539,208	413,859	316,718	279,049	3,537,822
Shpenzime bankare (komisio disbursimi/ paketa e siguracioneve/kom mirembajtje/nt ovd)							474,225	2,875	3,365	9,612	5,195	4,305	3,520	0	503,096
Shpenzime per kompletim apt **** (DPV 2012)								100,000	300,000	600,000			100,000		1,100,000
Shpenzime per mobilim/pajisje apart S Frasheri (pyets standart)		30,000		100,000	200,000		50,000						70,000		450,000
Shpenzime tatimi mbi te ardhuren e perfitur nga shitja e apt Kukes		10,000													10,000
Shpenzime pagese per shkollimin e femijeve (npm bkt)													77,838	172,689	250,526
Shpenzime udhetimi ne vendin e punes	39,600	145,200	145,200	145,200	145,200	96,800	48,400	48,400	48,400	48,400	118,800	132,000	48,400	48,400	1,258,400
Shpenzime udhetim TIMS		-	41,051	-	79,662	-	205,755	91,015	15,232	99,554	107,081	325,657	-	290,312	1,255,318
Mundesia per Kursime	- 344,722	763,525	- 428,548	664,002	278,796	474,986	355,674	197,958	299,761	87,116	332,539	448,429	838,177	263,538	4,505,414
PAMUNDESIA FINANCIARE TOTALE															(773,270)

KONTROLLI I FIGURËS

34. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Edmond Koloshi, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 30.3.2021, të KDZH-së, nga ku rezultojnë se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Edmond Koloshi. Pasi është kërkuar përditësimi i të dhënave, ka rezultuar se nuk disponohen të dhëna të përditësuara për subjektin Edmond Koloshi. SPAK-u³¹ ka informuar se në emër të z. Edmond Koloshi nuk rezultojnë të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni nuk evidentoi fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, të cilat do të ndryshonin konstatimin fillestar të Grupit të Punës të AKSIK-së, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit Edmond Koloshi është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

35. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Edmond Koloshi, bazuar në: (i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me nr. *** prot., datë 10.7.2023 dhe nr. *** prot., datë 24.7.2023; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

36. Raporti për analizimin e aftësive profesionale të kryer nga KLP-ja është bazuar në formularin e vetëdeklarimit dhe dokumentet shoqëruese, tri dosjet e përzgjedhura nga Komisioni dhe pesë dosjet e shortuara, si dhe në të dhënat arkivore. Pasi ka analizuar të dhënat si më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit Edmond Koloshi si vijon:

Për aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore. Prokurori Edmond Koloshi shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit, aftësi shumë të mira në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi, njohuri të mira edhe në drejtim të kuptimit dhe zbatimit të akteve që normojnë fushën e ndërtimit, institucioneve përgjegjëse në këtë fushë, detyrave përkatëse të çdo punonjësi të këtyre institucioneve. Ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret për procedimet për të cilat janë ndjekur nga prokurori. Identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme, bën interpretim sistematik dhe logjik të normës ligjore në raport me faktin e referuar dhe konkludon në një zgjidhje ligjore të rastit.

b) Arsyetimi ligjor. Subjekti i rivlerësimit Edmond Koloshi shfaq aftësi në arsyetim ligjor, tregon kujdes që konkluzionet e tij përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt dhe bazës ligjore të përdorur gjatë arsyetimeve. Bën analizë mbi rrethanat e faktit, analizë e zgjeruar e provave të mbledhura, provave të paraqitura nga mbrojtja, si dhe kërkesave dhe

³¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 10.11.2021, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

pretendimeve të mbrojtjes, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore të çështjeve në ndjekje.

Për aftësitë organizative

a) *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë.* Sipas të dhënave rezulton se për periudhën e punës prokurori ka trajtuar 399 çështje. Prokurori Edmond Koloshi tregon vëmendje në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara. Subjekti Edmond Koloshi ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuara dhe numrin total të çështjeve të përfunduara, për të gjithë periudhën e vlerësimit.

b) *Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore.* Prokurori Edmond Koloshi kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Në njoftimet e vendimmarrjeve konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse subjekteve. Gjithashtu vihet re se qëndrimi i prokurorit në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.

c) *Aftësia për të administruar dosjet.* Prokurori ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar në dosjet përkatëse. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit.

Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

a) *Etika në punë.* Gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nuk rezulton të ketë pasur ankesa se nga ana e subjektit të jenë kryer veprime apo mbajtur qëndrime të tilla, jo në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) *Integriteti.* Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Edmond Koloshi dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) *Paanësia.* Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Edmond Koloshi. Nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Për aftësitë personale dhe angazhimin profesional

a) *Aftësitë e komunikimit.* Nga 3 dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe 5 dosjet e përzgjedhura në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) *Aftësia për të bashkëpunuar.* Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit Edmond Koloshi për vitet 2012, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm rezulton se është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit.

c) *Gatishmëria për t’u angazhuar.* Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, subjekti Edmond Koloshi rezulton se ka marrë pjesë në 6 trajnime me temë në fushën penale, të organizuar pranë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Nga ana e Komisionit u kryen verifikimet si vijojnë:

37. Nga tri dokumentet e paraqitura nga subjekti dhe pesë dosjet e zgjedhura me short, u vlerësua e arsyeshme të kryhen verifikime për dy dosje, si më poshtë:

37.1. Pas verifikimeve në lidhje me dosjen nr. 2 të shortuar “Vendim për pushimin e çështjes nr. ***, viti 2015” i përpiluar dhe nënshkruar nga prokuror Edmond Koloshi, sikurse është trajtuar

në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, në përfundim të këtij hetimi nuk rezultuan problematika që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit.

37.2. Pas verifikimeve në lidhje me dosjen nr. 4 të shortuar “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. ***, viti 2014”, u konstatua se me anë të këtij akti prokurori Edmond Koloshi, pasi ka analizuar provat dhe faktin, konstaton se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën ai akuzohet, provat janë të plota në ngarkim të tij dhe për këtë arsye duhet të gjykohet nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

37.2.1. Nga ana e Komisionit u krye verifikimi i dosjes penale, ku rezultoi se:

- Sipas formularit për trajtimin e materialit kallëzues, i datës 1.9.2015, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit kallëzimi i referuar nga Komisariati i Policisë Lezhë, si dhe të regjistrohet procedimi penal për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal, me autor A. H.. Në këtë datë subjekti ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të shtetasit A. H. Nga materialet e referuara vërehet se:

- Sipas referimit të veprës penale datë 3.8.2015, rezulton se i janë kaluar prokurorisë materialet hetimore në ngarkim të shtetasit A. H. për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” dhe në ngarkim të shtetasve P. N. dhe P. D. për veprën penale “Punësim i paligjshëm”.

- Sipas formularit të raportimit të ndalimit/shoqërimit të policisë datë 1.8.2015, rezulton informacioni për ndërtim të paligjshëm dhe është konstatuar nga shërbimet e policisë duke punuar në banesës e tij shtetasi A. H., dhe më pas janë shoqëruar tri persona pasi nuk kishin dokumentet përkatëse.

- Në datën 1.8.2015 është mbajtur procesverbal i këqytjes së vendit të ngjarjes nga OPGJ-ja, sipas të cilit rezulton se banesa e shtetasit A. H. është 2-katëshe etj.

- Sipas procesverbalit të datës 1.8.2015 shtetasi A. H. deklaron se ai i ka kërkuar një personi të ngjisë në soletë tek banesa e tij tri zgara hekuri për hedhje betoni. Më pas ka shkuar në komunë për t’u interesuar pasi kishte aplikuar për leje për zhvillimin e punimeve.

- Sipas dokumenteve të pronësisë, shtëpia e shtetasit A. H. është 1 kat.

- Sipas procesverbaleve të datës 1.8.2015, shtetasit P. D. dhe P. N. deklarojnë se kanë ndihmuar shtetasin A. H. për të ngritur tri zgara hekuri për hedhje betoni dhe më pas janë shoqëruar në stacionin e policisë, si dhe kanë deklaruar se nuk merren me ndërtim.

- Me shkresën datë 3.8.2015 Komuna *** ka informuar se pas shqyrtimit të kërkesës dhe deklaratës paraprake të kryerjes së punimeve, kërkesa e shtetasit A. H. për rikonstruksion është pranuar.

- Sipas shkresës datë 2.11.2015 të Njësisë Administrative ***, pas verifikimit të grupit të IKMT-së, rezulton se shtetasi A. H. në objektin ekzistues ka bërë rikonstruksion sipas autorizimit dhe mbi të ka ndërtuar shtesë kati pa leje (një kat të plotë) mbi atë ekzistues.

- Me shkresën e datës 14.1.2016, Bashkia Lezhë, ndër të tjera, ka informuar se pas verifikimit të grupit të IKMT-së, rezulton që shtetasi A. H. në objektin ekzistues ka bërë rikonstruksion (sipas autorizimit nga ish-Komuna ***) dhe mbi të ka ndërtuar shtesë kati (një kat të plotë) mbi atë ekzistues.

- Në datën 26.11.2015 është ftuar shtetasi A. H. për t’u paraqitur tek prokurori. Në datën 25.1.2016, policia ka dërguar materialin mbi kërkimin e personit. Në datën 8.1.2016 është lëshuar urdhri për kërkimin e të pandehurit A. H.. Në datën 26.1.2016 është marrë vendim për mosgjyqjen e të pandehurit A. H. dhe caktimin e mbrojtësit.

- Në datën 18.1.2016 subjekti i rivlerësimit, pasi ka parashtruar sa më sipër dhe ka konkluduar se shtetasi A. H. ka ndërtuar pa lejen e organeve kompetente, ka vendosur marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga

neni 199/a/1 i Kodit Penal. Në datën 27.1.2016 është mbajtur procesverbali për njohje me aktet. Të dyja këto akte janë marrë nga mbrojtësi i vendosur kryesisht, pasi i pandehuri nuk gjendej.

- Në datën 2.2.2016 subjekti ka dërguar për gjykim kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. ***, duke arsyetuar në thelb se shtetasi A. H. ka qenë i autorizuar për rikonstruksion dhe mbi të ka bërë një shtesë kati të plotë dhe se fakti dhe fajësia provohet nga aktet e dosjes. Në diskutimet përfundimtare subjekti është shprehur se në seancë gjyqësore mbrojtësi ka paraqitur një vërtetim nga AULIZNI për legalizim objekti me dosjen nr. ***, datë 19.12.2014, por fakti se i pandehuri ka aplikuar për legalizim nuk e përjashton atë nga përgjegjësia penale për veprën penale parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal.

- Me vendim nr. ***, datë 4.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes në ngarkim të shtetasit A. H. për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/1. Në arsyetimin e saj gjykata në mënyrë të përmbledhur, ndër të tjera, është shprehur se:

- *Nga avokati mbrojtës në seancë është paraqitur një vërtetim datë 13.5.2015 nga ALUIZNI Lezhë, ku vërtetohet se A. H. ka aplikuar për legalizim objekti në dosjen nr. ***, datë 19.12.2014.*

- *Prokuroria parashtron se A. H. me datë 1.8.2015 ka qenë duke ndërtuar shtesë kati pa lejen e organeve kompetente.*

- *Gjatë periudhës 2001 A. H. ka ngritur katin e dytë dhe ka ndërprerë punimet totalisht në vitin 2010, si dhe ai ka paraqitur dokumentacionin nga ALUZINI, etj. Është vërtetuar se banesa me nr. pasurie 31 objekt gjykimi, ndërtimi i kësaj shtese të katit të dytë është deklaruar se është ndërtuar që në vitin 2001 dhe që nga ai vit nuk është bërë asnjë shtesë/ndërtim pa leje siç pretendon Prokuroria.*

- *Nuk provohet se ditën e ngjarjes i pandehuri ka kryer punime dhe nga krahasimi i fotove të policisë me ato të paraqitura tek ALUZINI gjendja është e njëjtë.*

- *Ka qenë detyrë e policisë gjyqësore dhe e prokurorisë të thërriste një ekspert të fushës së ndërtimit për të verifikuar, përcaktuar dhe klasifikuar se çfarë punimesh po kryheshin.*

Ligji nr. 22/2014 për dhënie amnistie dhe ligji për legalizimin, tregojnë se procedimi penal nuk duhej të kishte filluar ose të paktën pas verifikimeve duhej pushuar.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim akuza. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 27.6.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 4.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke arsyetuar ndër të tjera se:

- *Vendimi nr. ***, datë 4.5.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është marrë në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe material dhe provat e marra në gjykim, pasi fakti penal për të cilin është akuzuar i pandehuri është amnistuar nga ligji nr. ***, “Për dhënie amnistie”, i miratuar pas shpalljes së vendimit të shkallës së parë. Në lidhje me qëndrimin e mbajtur nga gjykata e shkallës së parë, Gjykata e Apelit e vlerëson të panevojshëm analizimin e bazueshmërisë së tij në prova, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur pushimin e çështjes, mbështetur në ligjin nr. 92/2015 për disa shtesa në ligjin nr. 22/2014 dhe duke qenë se kjo vepër penale amnistohet edhe me ligjin nr. 141/2016, vlerësohet se vendimi i shkallës nuk mund të cenohet prandaj duhet të lihet në fuqi.*

37.2.2. Sa më sipër, nisur nga aktet e dosjes penale dhe vendimet e gjykatave në lidhje me çështjen penale nr. ***, duket se subjekti i rivlerësimit: (i) nuk ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të shtetasve P. N. dhe P. D. për veprën penale “Punësimi i paligjshëm” sipas referimit të veprës penale në prokurori; (ii) nuk ka thirrur një ekspert të fushës së ndërtimit për të verifikuar, përcaktuar dhe klasifikuar se çfarë punimesh po kryheshin; (iii) ashtu siç ka arsyetuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. ***, datë 4.5.2016, bazuar në ligjin nr. 22/2014, “Për dhënie amnistie” dhe ligjin “Për legalizimin”, procedimi penal nuk duhej të kishte filluar ose të paktën pas verifikimeve duhej pushuar. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016,

subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

37.2.3. Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve të subjektit vërehet se:

i) Në lidhje me konstatimin e parë, parashtrori se vepra penale “Punësimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 170/a i Kodit Penal, parashikon ndër të tjera: *“Punësimi pa regjistrim në organet kompetente ose pa garantuar sigurimin e të punësuarit sipas rregullave, kur është dhënë më parë masë administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë deri në 10 mijë lekë për çdo rast ose me burgim deri në 1 vit”*. Sipas subjektit:

Së pari, kjo figurë vepre penale ka si subjekt të saj personat juridikë apo fizikë (tatimpagues) që punësojnë punonjës pa i deklaruar në organin tatimor për pagimin e shumës së detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore (neni 119 “Mosdeklarimi i punonjësve”, ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”). Në rastin konkret shtetasit P. N. dhe P.D. janë të punësuar dhe jo punëdhënës.

Së dyti, nuk u referua dhe nuk rezultoi se shtetasi A. H. është person fizik apo juridik i regjistruar në QKB, apo organet tatimore.

Së treti, që të jemi përpara elementeve të figurës së veprës penale “Punësimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 170/a i Kodit Penal, kërkohet që ndaj subjektit tregtar që punëson në mënyrë të paligjshme punonjës duhet të jenë marrë më parë masa administrative nga organet tatimore të cilat e kanë detyrë të posaçme verifikimin e punonjësve në subjektet tregtare. Në rastin e mësipërm nuk referohej se kemi të bëjmë me subjekt tregtar e aq më tepër që ndaj këtij subjekti të jenë marrë më parë masa administrative për punësim të paligjshëm.

Në këto kushte, nuk mund të regjistrohej procedim për veprën penale “Punësimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 170/a i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasve P. N. dhe P. D.

Në përfundim të procesit vlerësohet se pretendimet e subjektit qëndrojnë dhe se subjekti ka vepruar bazuar në prova dhe në ligj.

ii) Në lidhje me konstatimin e dytë, subjekti parashtrori veprimet hetimore të pasqyruara në dosjen penale që në mënyrë të përmbledhur konsistojnë në: OPGJ-ja ka dokumentuar se në datën 1.8.2015, shtetasi A. H. së bashku me dy punëtorë po ndërtonte katin e dytë të banesës; nga këqyrja e vendit të ngjarjes, rezultoi se objekti i vjetër është njëkatësh dhe i rikonstruktuar tashmë, ndërkohë janë kryer punime për ndërtimin e katit të dytë; nga shkresa nr. *** prot., datë 3.8.2015, e Komunës ***, rezultoi se i pandehuri A. H. ka bërë një deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve për rikonstruksionin e objektit ekzistues 1 kat; nga shkresa nr. *** prot., datë 14.1.2016, e Njësisë Administrative ***, konfirmohet ndër të tjera se pas verifikimit nga grupi i IKMT-së, rezultoi se shtetasi A. H. në objektin ekzistues ka bërë rikonstruksion (sipas autorizimit të lëshuar nga ish-Komuna ***) dhe mbi të ka ndërtuar shtesë kati (një kat të plotë) mbi atë ekzistues; gjatë hetimeve paraprake, i pandehuri A. H. nuk është paraqitur për të dhënë shpjegime, por ka dalë nga Republika e Shqipërisë dhe është deklaruar mosgjettja e tij.

Në këtë mënyrë, subjekti argumenton se nuk është kryer ekspertim teknik, pasi nga aktet e mësipërme si dhe nga provat e gjetura në vendngjarje del e provuar se mbi objektin ekzistues është bërë ndërtim pa leje që ishte në fazë punimesh ndërtimi dhe nuk ka dalë e nevojshme kryerja e ekspertimit teknik. Sipas subjektit, gjatë gjykimit nga ana e mbrojtësit u paraqitën akte se A. H. etj. ka aplikuar për legalizim objekti me dosjen nr. *** prot., datë 19.12.2014 dhe ka paraqitur disa foto që mbajnë datën 5.11.2014, që paraqesin shtesën e katit të dytë, me mure anësore, por pa soletë betoni, ku kishte vendosur vetëm armaturën e dërrasës. Ky fakt nuk e përjashton të pandehurin nga përgjegjësia penale për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal, por përkundrazi provon ekzistencën e kësaj vepre penale. Më tej, subjekti argumenton se gjykimi i kësaj çështjeje është kryer në formën e gjykimit të zakonshëm dhe nëse gjykata do të gjykonte, siç edhe ka arsyetuar se është e nevojshme kryerja e një ekspertimi teknik, për të përcaktuar dhe klasifikuar se çfarë punimesh po kryheshin, mund

të kishte vendosur për kryerjen e ekspertimit në fazën e gjykimit dhe do të kishte administruar një akt të tillë për të dalë në konkluzione më të sakta, por nuk e ka bërë një gjë të tillë.

Në analizë të parashtrimeve të subjektit, vërehet se sipas tij akuza për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm” mbi bazën e akteve në dosje ishte e provuar dhe nuk ka qenë e nevojshme kryerja e ekspertimit teknik, pretendim që nga Komisioni konsiderohet i argumentuar. Nga ana tjetër, në konsideratë të pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit *aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndër marrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën*, nga ana e Komisionit vlerësohet se në këtë rast subjekti me veprimet dhe sjelljen e tij nuk ka treguar mangësi në kryerjen e hetimeve në ngritjen e akuzës, por është bazuar në bindjen e tij mbi prova/akte të administruara, kjo edhe në këndvështrim të parashikimit të pikës 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, sipas së cilës vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit.

iii) Në lidhje me konstatimin e tretë, subjekti parashtron se:

- Me ligjin nr. 92/2015 “Për disa shtesa në ligjin nr. 22/2014 “Për dhënie amnistie”, neni 2 parashikon se: *“Në nenin 5 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Amnistohen nga ndjekja penale të gjithë personat, të cilët akuzohen se kanë kryer veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, në rastet kur vepra penale në fjalë është kryer jo më vonë se data 10.4.2014”*. Rasti konkret përsëri përjashtohet nga amnistia e mësipërme, pasi dyshohet se vepra penale është kryer pas datës 10 prill 2014 dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka gabuar në aplikimin e ligjit të amnistisë, duke arsyetuar se ndërtimi është kryer para datës 10.4.2014. Subjekti, duke mos qenë dakord me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit, duke parashtruar një sërë shkaqesh.

- Në kohën që çështja ishte në Gjykatën e Apelit Shkodër³², ka dalë ligji nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie”, i cili në nenin 6 të tij parashikon: *“Pushohen ndjekjet penale për çështjet në hetim, për çështjet e pashqyrtuara ose në proces shqyrtimi nga gjykatat, si dhe për kallëzimet që ndodhen në këto organe, pavarësisht nga data e regjistrimit të tyre, për veprat penale të kryera deri në datën 25.12.2016, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burgim në maksimum deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë”*.

- Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit A. H., sipas ligjit nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie”, pa u hyrë fare argumenteve, analizimit dhe bazueshmërisë së provave të vendimit ***, datë 4.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Në analizë të parashtrimeve të subjektit, sa i takon qëndrimin të tij në lidhje me faktin se sipas Gjykatës së Shkallës së Parë, bazuar në ligjin nr. 22/2014 “Për dhënie amnistie” dhe ligjin “Për legalizimin”, procedimi penal nuk duhej të kishte filluar ose të paktën pas verifikimeve duhej pushuar nga ana e Komisionit, vlerësohet se subjekti ka qenë konsistent në interpretimin e ligjit nr. 22/2014 “Për dhënie amnistie”, si në logjikën e tij në hetime, ashtu dhe gjatë përfaqësimit të akuzës në gjyq³³, pasi ka vlerësuar se vepra penale ka ndodhur përtej datës 10.4.2014, fakt i nxjerrë në bazë të provave, si këqyrja e vendit të ngjarjes dhe dokumenteve të organeve shtetërore, në përputhje me dispozitat procedurale penale në lidhje me provat materiale, dokumentet etj. Referuar këtij qëndrimi, si dhe faktit që subjekti e ka ankimuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, ndërsa Gjykata e Apelit e ka lënë në fuqi, duke u bazuar në ligjin nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie” dhe jo mbi bazueshmërinë e provave të analizuara nga Shkalla e Parë, në këndvështrim të pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, në përfundim, Komisioni vlerësoi se në rastin konkret subjekti me veprimet dhe sjelljen e tij nuk ka treguar

³² Subjekti ka paraqitur kopje vendimi nr. ***, datë 27.6.2017, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

³³ Neni 24/1 i Kodit Penal.

mangësi në kryerjen e hetimeve, aftësinë e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, interpretimin e ligjit në ngritjen e akuzës dhe dërgimin e përfaqësimit e çështjes në gjykim.

38. Nga të dhënat arkivore ka rezultuar se ndaj prokurorit Edmond Koloshi nuk janë dhënë masa disiplinore dhe, sipas vlerësimeve të Prokurorit të Përgjithshëm për vitet 2012, 2015 dhe 2016, ai është vlerësuar “shumë mirë”. Në lidhje me kallëzimet penale/ankesa në adresë të subjektit nga aktet, ka rezultuar se:

- Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka informuar se në lidhje me prokurorin Edmond Koloshi rezulton të jetë regjistruar materiali kallëzues nr. *** i vitit 2019, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal.

- Ndaj prokurorit Edmond Koloshi ka paraqitur një kallëzim penal në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar shtetasi V. V. Më pas, ky kallëzim i ka kaluar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin datë 8.11.2020 ka vendosur mosfillim. Sipas dokumenteve të paraqitura në parashtrime nga subjekti, vendimi i mosfillimit është me statusin “i ankimuar”. Gjithashtu, shtetasi V. V. ka paraqitur pranë Prokurorisë së Përgjithshme edhe një ankesë, e cila është përcjellë për kompetencë në ILD dhe tek kjo e fundit ankesa ndodhet në fazën e shqyrtimit fillestar. Në seancën dëgjimore datë 13.11.2023, subjekti paraqiti vendimin nr. *** prot., datë 8.11.2023, të ILD-së, i cili ka vendosur arkivimin e ankesës.

- Ndaj prokurorit Edmond Koloshi ka paraqitur ankesë/kallëzim penal në Prokurorinë e Përgjithshme shtetasi K. V., i cili më pas është përcjellë për kompetencë në Prokurorinë e Krimeve të Rënda Tiranë dhe kjo e fundit ia ka kaluar për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka regjistruar procedimin penal nr. *** dhe në përfundim të hetimeve ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për pushimin e këtij procedimi. Në parashtrime, subjekti sqaroi dhe provoi me dokumente se me vendimin nr. *** akti, datë 22.11.2018, gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes penale nr. *** dhe se kundër këtij vendimi nuk është bërë ankim.

- Ndaj prokurorit Edmond Koloshi ka paraqitur ankesë/kallëzim penal pranë Prokurorisë së Përgjithshme shtetasi M. K., e cila më pas i ka kaluar për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, datë 14.2.2019 dhe pas verifikimeve me vendimin e datës 18.2.2019 ka vendosur mosfillim. Në parashtrime, subjekti sqaroi dhe provoi me dokumente se nuk rezulton që ndaj vendimit të datës 18.2.2019 për mosfillimin e procedimit penal të jetë ushtruar ankim në gjykatë nga shtetasi M. K.

- Ndaj prokurorit Edmond Koloshi ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës shtetasi P. Gj. Më pas, ky kallëzim i ka kaluar për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, e cila ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, datë 18.12.2017 dhe pas verifikimeve me vendimin e datës 28.12.2017 ka vendosur mosfillim. Në parashtrime, subjekti sqaroi dhe provoi me dokumente se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë nuk është regjistruar kërkesë me kërkues shtetasin P. Gj. kundër vendimit të mosfillimit të datës 28.12.2017.

39. Si informacion i marrë nga burime të ligjshme janë konsideruar 19 denoncime nga publiku, pas shqyrtimit të të cilave u konstatua se disa prej tyre kanë qenë të përsëritura dhe nga i njëjti person. Nga ana e Komisionit janë kryer verifikimet për tre denoncues, si vijojnë:

40. Denoncim³⁴ nga shtetasi K. V.

Shtetasi K. V. ka paraqitur një kallëzim penal ndaj prokurorit F. B. drejtuar Prokurorisë, si dhe Komisionit. Në përmbajtje të këtij kallëzimi, denoncuesi pretendon se pas dërgimit të dosjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës subjekti i rivlerësimit ka zvarritur fillimin e gjyqimit, ku

³⁴ Shihni denoncimin, protokolluar me nr. ***, datë 14.6.2018.

grykata me vendimin nr. ***, datë 3.5.2018, ka shpallur të pafajshme J. K. Denoncuesi nuk ka paraqitur ndonjë dokument. Në lidhje me këtë çështje u evidentua se:

Nga kërkimi në sistemin³⁵ e Grykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, rezultojnë çështja me nr. ***, nr. vendimi ***, datë 3.5.2018, me të pandehur J. K., me përfaqësues të Prokurorisë Edmond Koloshi dhe, më pas, të prokurores O. Rr. Sipas seancave gjyqësore, vërehet se në 4 seanca të datave 12.12.2017, 15.1.2018, 25.1.2018 dhe 2.3.2018 nuk është paraqitur përfaqësuesi i organit të akuzës.

Nga aktet e ndodhura në dosjen penale nr. ***³⁶, rezultojnë se me vendimin e datës 7.11.2017 është caktuar Edmond Koloshi për të përfaqësuar çështjen në gjykim. Nga data 9.1.2018 deri më 16.1.2018 ai ka qenë i caktuar me kohë të plotë në grup pune në kuadër të procesit *Vetting* dhe gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur mundësi objektive të marrë pjesë në seancat gjyqësore. Nga procesverbalet e seancave të administruara në dosje ka rezultuar se në seancat e datave 25.1.2018 dhe 2.3.2018 prokurori Edmond Koloshi nuk u paraqit.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit iu kërkuan sqarime subjektivit në lidhje me konstatimin, ku duket se pretendimet e denoncuesit për zvarritje të procesit gjyqësor qëndrojnë, pasi subjekti i rivlerësimit pa shkaqe objektive nuk është paraqitur në 3 seanca gjyqësore. Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi se seanca e datës 2.3.2018 ishte planifikuar për t'u zhvilluar në orën 11:30. Ai është paraqitur në orar, por sipas procesverbalit të kësaj seance ajo ka nisur me vonesë për shkak të vazhdimëve me gjykime të tjera të mëparshme. Pra, vetë gjykata ka qenë me vonesë 30 minuta e, për pasojë, mosprania e tij ka qenë për shkak të mungesës së organizimit të seancave gjyqësore në kohë. Në mbështetje të pretendimeve paraqiti urdhrin nr. ***, datë 9.1.2018, ku është caktuar në grup pune në kuadër të procesit të *Vetting*-ut dhe urdher nr. ***, datë 26.1.2018, të Prokurorit të Përgjithshëm për heqjen dhe zëvendësimin e tij në këtë grup pune. Po kështu, ka paraqitur printim të akteve "Kalendari i seancave gjyqësore të datës 3.2.2023", si dhe "Procesverbal të seancës gjyqësore" të çështjes nr. ***, datë 2.3.2018, ora e fillimit 12:00.

Në analizë të sqarimeve dhe dokumenteve të paraqitura në lidhje me mosparaqitjen në seancat e zhvilluara në periudhën 9.1.2018 – 26.1.2018 dhe atë të datës 2.3.2018, pretendimet e subjektivit qëndrojnë, pasi bazohen në akte shkresore, pra ai për shkaqe objektive nuk ka pasur mundësi të paraqitet. Ndërsa për mosparaqitjen në seancën e datës 12.12.2017 subjekti nuk dha ndonjë sqarim, por duke mbajtur në konsideratë se është një rast i vetëm i kësaj natyre vlerësohet se nuk cenon aftësitë profesionale të subjektivit të rivlerësimit.

41. Dy denoncime³⁷ nga shtetasi V. V.

Denoncuesi ngre pretendime ndaj disa prokurorëve dhe OPGJ-ve, përfshirë edhe subjektivin e rivlerësimit në lidhje me dy procedime penale, nr. *** dhe nr. ***. Sa i takon subjektivin, denoncuesi në thelb pretendon se nuk ka kryer hetime (*ka mbyllur kallëzimin penal për falsifikim duke mbrojtur falsifikatorët*). Pas pushimit të çështjes, Grykata e Rrethit Gjyqësor dhe ajo e Apelit kanë vendosur vazhdimin e hetimeve. Më pas, hetimet i mori prokurori N. T. Ndër dokumentet e paraqitura ndodhen: (i) kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. *** të subjektivit të rivlerësimit, duke arsyetuar se nga hetimi nuk u arrit të provohej se jemi para elementeve të veprës penale "Falsifikim i dokumenteve"; (ii) vendim i Grykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. ***, datë 19.3.2018, ku është vendosur mospranimi i kërkesës së prokurorit, kthimi i akteve, vazhdimi i hetimeve dhe kryerja e detyrave të përcaktuara në vendim etj.; (iii) ankimi i subjektivit të rivlerësimit ndaj vendimit të gjykatës, si dhe vendim i Grykatës së Apelit datë 26.4.2018, i cili ka lënë në fuqi vendimin e Shkallës së Parë. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se:

³⁵ <https://www.gjykata.gov.al>***

³⁶ Shihni dosjen e dërguar nga KLP-ja me raportin e rivlerësimit.

³⁷ Shihni denoncimet, protokolluar me nr. ***, datë 14.6.2018 dhe nr. ***, datë 13.9.2018.

41.1. Nga aktet e përcjella nga raporti i KLP-së³⁸ rezulton se denoncuesi ka bërë kallëzim penal ndaj subjektit për veprën penale “Shpërdorim detyre” në lidhje me pushimet e procedimeve nr. *** dhe nr. **. Nga verifikimet e kryera në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me pushimin e procedimit penal nr. **, me vendimin e datës 8.11.2020, prokurori, pasi ka parashtruar ndër të tjera ecurinë e procedimit penal nr. **, kërkesat për pushimin e tij, si dhe vendimet e gjykatave të rrethit gjyqësor dhe të apelit, të cilat i kanë shfuqizuar duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve, faktin se pas rifillimit të hetimeve datë 26.6.2019 dhe gjatë hetimeve paraprake, me kërkesë të kallëzuesit është vendosur zëvendësimi i prokurorit, duke caktuar si prokuror z. Edmond Koloshi etj., ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, për shkak se fakti nuk përbën veprë penale. Ndërsa në lidhje me pushimin e procedimit penal nr. ** nuk është shprehur.

41.2. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkuar sqarime shoqëruar me dokumentacion në lidhje me konstatimin duket se bazuar në konstatimet e vendimeve të gjykatave subjekti nuk ka kryer hetime të plota për procedimet penale nr. ** dhe nr. **.

41.3. Në lidhje me procedimin penal nr. **, në mënyrë të përmbledhur subjekti parashtroi se në datën 8.6.2010 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. ** për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” mbi bazën e kallëzimit të shtetasit V. V. Në datën 28.4.2011 është vendosur pushimi i hetimeve të procedimit penal nr. ** dhe me vendime të gjykatave është kthyer disa herë për hetime. Në datën 28.6.2019 është vendosur zëvendësimi i prokurorit që kishte çështjen në ndjekje (i disati prokuror i zëvendësuar më kërkesë të z. V. V.), duke caktuar subjektin si prokuror për hetimin e kësaj çështjeje. Pra, ky është momenti që ai ka marrë në ndjekje këtë çështje.

Sa i takon veprimeve të kryera nga ana e tij, sqaroi se në datën 17.12.2019 ka dërguar kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. **, me arsyetimin se nga hetimet rezultoi se ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilën ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë, siç është parashkrimi i ndjekjes penale. Gjatë gjykimit në seancë paraprake, përfaqësuesja ligjore e kallëzuesit deklaroi se shtetasi N. S. ka vdekur dhe gjykata, me vendimin datë 24.2.2020, ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal nr. ** prokurorisë, duke arsyetuar se nga ana e prokurorisë duhet të bëhen verifikimet përkatëse në lidhje me faktin e parashtruar nga palët në seancë se i kallëzuari N. S. ka vdekur. Pasi ka kryer detyrat e lëna nga gjykata, në datën 5.6.2020 ai ka paraqitur kërkesën për pushimin e çështjes penale, me arsyetimin se ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilën ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë, siç është parashkrimi i ndjekjes penale, si dhe për shkakun se autori i dyshuar ka ndërruar jetë. Po kështu, bazuar në nenin 391 të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar të deklarohet falsiteti i dokumentit “Kontrata për shitje apartamenti banimi etj.”, si dhe të urdhërohet fshirja tërësore e saj në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

Më tej, subjekti sqaron se në datën 27.10.2020 shtetasi V. V. ka paraqitur kërkesë për zëvendësimin e prokurorit Edmond Koloshi, pasi ndaj prokurorit është paraqitur kallëzim penal. Subjekti në datën 9.11.2020 ka deklaruar dorëheqjen nga ky procedim dhe me vendimin datë 9.11.2020 është vendosur zëvendësimi i tij në gjykim me prokurorin P. D., ndërsa gjykata me vendimin datë 11.2.2021 ka vendosur kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve. Më pas, prokurori i çështjes, pasi ka kryer detyrat e lëna nga gjykata, ka kërkuar në gjykatë pushimin e çështjes dhe deklarimin e falsitetit të disa dokumenteve dhe gjykata, me vendimin datë 8.6.2021, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë për pushimin e çështjes, deklarimin e falsitetit të disa dokumenteve, si dhe fshirjen e tyre nga regjistrat hipotekorë dhe korrigjimin e numrit të pasurisë së pronës, vendim i cili është lënë në fuqi me vendimin datë 13.9.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës.

³⁸ Shihni dosjen e kallëzimit penal nr. **.

Në mbështetje të parashtrimeve të tij, subjekti ka paraqitur shkresën datë 26.10.2023 të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me kopje të vendimeve të datave 24.2.2020, 11.2.2021 dhe 8.6.2021. Sipas vendimit të gjykatës datë 24.2.2020, rezulton se subjekti, pasi ka kryer disa veprime hetimore të lëna nga gjykata, ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. ***, si dhe deklarimin e falsitetit dhe fshirjen etj., duke arsyetuar ndër të tjera se veprat penale janë parashkruar dhe gjykata ka vendosur kthimin e akteve, me arsyetimin se në seancë paraprahe të datës 24.2.2020 përfaqësuesja ligjore e kallëzuesit deklaroi se shtetasi N. S. ka ndërruar jetë, fakt për të cilin është njoftuar nga familjarët e tij dhe se nga ana e prokurorisë duhet të bëhen verifikimet përkatëse në lidhje me faktin se i kallëzuari N. S. ka vdekur. Sipas vendimit të gjykatës datë 11.2.2021, prokurori i çështjes P. D. ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. ***, duke arsyetuar ndër të tjera se veprat penale janë parashkruar, ndërsa gjykata ka vendosur kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve duke lënë detyrat. Sipas vendimit të gjykatës datë 8.6.2021, lënë në fuqi nga Apeli, prokurori i çështjes P. D. ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. ***, duke arsyetuar ndër të tjera se duke iu referuar kohës kur janë kryer veprimet, datë 12.3.2003 dhe në intervalin kohor 6.12.2006 – 17.4.2008, rezulton se kanë kaluar mbi 10 vjet dhe veprat penale janë parashkruar dhe Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur pranimin e pushimit të procedimit penal, si dhe deklarimin e falsitetit etj.

Në analizë të dokumenteve të administruara, parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti, konkludohet se në këtë rast subjekti i rivlerësimit ka qenë një nga prokurorët që ka ndjekur çështjen vetëm në një pjesë gjatë hetimeve paraprahe, periudhë gjatë së cilës ai ka kryer veprime hetimore. Më pas, ai është zëvendësuar dhe, pas ndjekjes së çështjes nga një tjetër prokuror, P. D., në përfundim edhe nga gjykata është pranuar kërkesa e prokurorisë. Për sa më sipër, në tërësinë e ecurisë së procedimit penal nr. ***, dhe referuar faktit që veprat penale janë parashkruar para se çështja të ndiqej nga subjekti, nga ana e Komisionit vlerësohet se për këtë rast sjellja dhe veprimet e subjektit kanë qenë të tilla që, në këndvështrim të pikës 4 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, nuk tregojnë mangësi sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale dhe të mbledhjes së provave të nevojshme.

41.4. Në lidhje me procedimin penal nr. ***, në parashtrimet e tij subjekti sqaroi se në datën 28.9.2017 është regjistruar ky procedim për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, të parashikuara nga nenet 186/1 të Kodit Penal. Ky procedim penal ka filluar në bazë të kallëzimit të shtetasit F. V. (i biri i ankuesit) kundër shtetasve D. Xh. dhe A. B. Ky procedim, pasi është kthyer nga gjykata me vendimet e saj nr. ***, datë 19.3.2018 dhe nr. ***, datë 11.2.2019, ndodhet në hetim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe ndiqet nga prokurori P. D. Në mbështetje të parashtrimeve të tij, subjekti paraqiti shkresën datë 27.1.2023, sipas së cilës procedimi penal nr. *** është kthyer nga gjykata me vendimet e datave 19.3.2018 dhe 11.2.2019, procedim i cili është nën hetim dhe ndiqet nga prokurori Pali Deçolli, si dhe shkresën datë 26.10.2023 të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, së bashku me kopje të vendimeve të gjykatës, datë 19.3.2018 dhe datë 11.2.2019.

Sipas vendimit të gjykatës³⁹ nr. ***, datë 19.3.2018, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin datë 26.4.2018, rezulton se në lidhje me kërkesën e subjektit për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 28.7.2017, në ngarkim të shtetasve D. Xh. dhe A. B., gjykata ka vendosur kthimin e akteve prokurorisë, pasi hetimet e kryera nuk janë të plota, duke caktuar detyra si: pyetjen e personave, kryerjen e ekspertimit teknik – shkrimi, ballafaqimin e personave, zgjerimin e hetimeve ndaj shtetasve D. Xh. dhe A. B.

Sipas vendimit nr. ***, datë 11.2.2019, të Gjykatës, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit me vendimin datë 16.4.2019, rezulton për kërkesën e prokurorit N. T. në lidhje me procedimin nr. ***, datë 28.7.2017, për dërgimin në gjykim të çështjes në ngarkim të të pandehurit D. Xh. dhe pushimin e çështjes në ngarkim të personit nën hetim A. B., gjykata ka vendosur kthimin e akteve prokurorisë. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se pas kthimit të akteve prokurorisë, me

³⁹ Ky vendim ishte paraqitur edhe nga vetë denoncuesi.

vendim të gjykatës datë 19.3.2018, janë kryer disa veprime hetimore, si kryerja e aktit të ekspertimit etj., por nuk janë kryer plotësisht të gjitha veprimet e lëna.

Në analizë të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti sa i përket konstatimit se në lidhje me procedimin penal nr. *** nuk ka kryer hetime të plota, subjekti nuk dha ndonjë sqarim konkret dhe nuk mbajti ndonjë qëndrim kundërshtues. Në këto kushte, nga ana e Komisionit vlerësohet se për këtë rast subjekti ka treguar mangësi në këndvështrim të pikës 4 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016, sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore/ procedurale dhe të mbledhjes së provave të nevojshme gjatë kohës që çështja është ndjekur nga ana e tij. Por, duke mbajtur në konsideratë vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit *është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore të përsëritura dhe serioze dhe që tregojnë mungesë të aftësive profesionale*, vlerëson se ky rast i vetëm nuk mund të shërbejë shkak për një vlerësim negativ të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

42. Shtatë denoncime⁴⁰ nga shtetasi K. H.

Denoncuesi ngre pretendime në lidhje me disa prokurorë, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit për akuzën ndaj tij “Vrasje me dashje”, që ka të bëjë me ngjarjen e tërmetit të ndodhur në vitin 2019. Bashkëngjitur denoncimeve ka paraqitur dhe disa dokumente. Denoncuesi pretendon se është akuzuar me pa të drejtë për veprën penale “Vrasje me dashje”, si dhe pretendon se subjekti ka shpërdoruar detyrën dhe ka falsifikuar.

42.1. Në lidhje me këtë çështje u konstatua se:

- Nga verifikimi në sistemin⁴¹ e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës rezulton vendimi nr. ***, datë 31.5.2023, sipas të cilit i pandehuri K. H. është deklaruar fajtor për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe është dënuar me kohën e paraburgimit.

- Në Prokurorinë⁴² pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë janë regjistruar 3 kallëzimet penale të bëra nga shtetasi K. H. ndaj subjektit të rivlerësimit dhe gjyqtarëve/prokurorëve të tjerë, për të cilat është vendosur mosfillim, konkretisht: kallëzimi nr. *** për veprën penale “Korrupsion pasiv i gjyqtarëve dhe prokurorëve”, kallëzimi nr. *** për “Falsifikim” dhe “Shpërdorimi i detyrës”; kallëzimi nr. *** për “Falsifikim”.

- Pretendimet e denoncuesit janë të natyrës që në thelb kanë të bëjnë me vendimmarrjen dhe vlerësimin e provave, që në bazë të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 dalin jashtë tagrit të Komisionit, si dhe vlerësohet se ai nuk përmban fakte dhe rrethana për hetime të mëtejshme. Po ashtu, ato janë bërë objekt hetimi penal dhe nuk janë në kompetencë të Komisionit.

42.2. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime shoqëruar me dokumentacion në lidhje me pretendimet e denoncuesit për akuzën e ngritur ndaj tij për veprën penale “Vrasje me dashje”, duke paraqitur dhe vendimin e gjykatës që ka shqyrtuar çështjen në ngarkim të shtetasit K. H. etj. Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se:

- Lidhur me pretendimet për ngritjen e akuzës “Vrasje me dashje”, subjekti sqaroi se në datën 29.11.2019, Prokuroria nëpërmjet një grupi hetimor prej tre prokurorësh ka regjistruar procedimin penal kryesisht nr. ***, pasi në datën 26.11.2019 në Durrës ka rënë një tërmet me magnitudë 6.4, i shkallës Richter. Si pasojë e këtij tërmeti janë dëmtuar një numër i konsiderueshëm banesash dhe objektesh të tjera, si dhe kanë gjetur vdekjen 23 persona në zonën e Durrësit. Ndër objektet në të cilat u shkakuan pasoja, ishte dhe shtëpia e pushimit të Ministrisë

⁴⁰ Shihni denoncimin të protokolluar me nr. ***, datë 9.5.2021; nr. ***, datë 15.2.2022; nr. ***, datë 18.11.2022; nr. ***, datë 20.12.2022; nr. ***, datë 20.4.202; nr. *** prot., datë 6.10.2023; shihni edhe denoncimin e shtetasit K. H. të paraqitur pas riçeljes së hetimit administrativ, protokolluar me nr. *** prot., datë 22.11.2023 dhe nr. *** prot., datë 24.11.2023, të përcjellë nga Kodi Penal në dosjen e Komisionit.

⁴¹ [https://www.gjykata.gov.al/***\)](https://www.gjykata.gov.al/***))

⁴² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.7.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në dosjen e Komisionit.

së Brendshme, Durrës, nga shembja e së cilës ka humbur jetën shtetasi B. H., me detyrë pedagog në Akademinë e Rendit, i cili ishte akomoduar atë natë në këtë objekt.

- Në datën 13.12.2019, pas veprimeve të para hetimore, është urdhëruar regjistrimi i veprave penale dhe autorëve në regjistrin e njoftimit të veprave penale në Prokurori, ku mes të tjerave është regjistruar edhe emri i shtetasit K. H. për veprën penale “Vrasje me dashje”, e parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal. Kjo vepër është regjistruar, pasi dyshohej se shtetasi K. H., me detyrë shef i shërbimeve pranë shtëpisë së pushimit të Ministrisë së Brendshme, kishte lejuar të akomodohej të ndjerin B. H. në datën 26.11.2019, në ambientet e katit të tretë, në shtëpinë e pushimit, objekt ky që më parë ishte shpallur i pashfrytëzueshëm nga grupi i ekspertëve. Ai dyshohej se veprën penale e kishte kryer në formën e dashjes indirekte, kishte të dhëna se ai, pasi eventualisht i ka parashikuar pasojat dhe pavarësisht se nuk i ka dëshiruar ato, me ndërgjegje ka lejuar ardhjen e pasojave (neni 15 i Kodit Penal). Ky ka qenë mendimi fillestar i grupit hetimor, i konsultuar edhe me eksperiencat e vendeve të tjera (Itali etj.) në rastet e ngjarjeve të tilla.

- Pas kryerjes së veprimeve të para hetimore, në datën 14.12.2019 është nxjerrë për 18 persona urdhër ndalimi, që është arritur të ekzekutohet nga policia gjyqësore për 9 persona, ndërsa për 9 të tjerë janë caktuar masa sigurimi në mungesë, ku për një pjesë të mirë të tyre janë ekzekutuar në vazhdim.

- Në përfundim të hetimeve, pasi janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në datën 15.7.2020, është vendosur të ngrihet akuza “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal për shtetasin K. H. dhe çështja është dërguar për gjykim, së bashku me 15 të pandehur të tjerë. Në përfundim të gjykimit paraprak, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 2.2.2021, ka vendosur, ndër të tjera, pranimin e kërkesës së prokurorëve për dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit K. H. për “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

- Çështja në ngarkim të këtij të pandehuri është zhvilluar në formën e gjykimit të zakonshëm (duke u shqyrtuar në themel të gjitha provat, dëshmitarë etj.) dhe në përfundim të gjykimit nga ana jonë është kërkuar deklarimi fajtor i të pandehurit K. H. për veprën penale “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, e bazuar në këtë dispozitë, dënimin e tij me një vit e gjashtë muaj burgim. Nga ana e saj, gjykata me vendimin nr. ***, datë 31.5.2023, ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurit K. H. për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe, në bazë të kësaj dispozite, dënimin e tij me kohën e paraburgimit.

- Në mbështetje të parashtrimeve të tij, subjekti ka paraqitur disa akte procedurale, nëpërmjet te cilave vërtetohet se:

i) Me urdhër të drejtueses së Prokurorisë Durrës, datë 29.11.2019, për regjistrimin e procedimit penal për veprat penale “Ndërtim pa leje” dhe “Shpërdorim detyre”, janë ngarkuar prokurorët Edmond Koloshi, P. D. dhe M. K.

ii) Me urdhrin datë 13.12.2019⁴³ prokurorët kanë vendosur regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, përfshirë dhe shtetasin K. H. për akuzën “Vrasje me dashje”, pasi ekzistojnë dyshime se me dashje indirekte ka sjellë pasojën e ardhur, humbjen e jetës së shtetasit B. H.

iii) Me vendimin nr. ***, datë 17.12.2019, gjykata ka vendosur vleftësimin si të ligjshëm të arrestit të personit nën hetim K. H., i dyshuar për veprën penale “Vrasje me dashje” dhe caktimin e masës “Arrest në burg”.

⁴³ Në këtë urdhër, grupi i prokurorëve ka vendosur dhe për katër të dyshuar të tjerë akuzën “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” dhe për një tjetër të dyshuar akuzën “Vrasje me dashje”.

iv) Me urdhrin datë 15.7.2020 për ndryshimin e cilësimit juridik në regjistrin e veprave penale, prokurorët pas hetimeve të kryera kanë vendosur, ndër të tjera, që K. H., i dyshuar si autor i veprës penale “Vrasje me dashje”, të ketë kryer veprën penale “Shpërdorim detyre”.

v) Me vendimin nr. ***, datë 31.5.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ndër të tjera, ka vendosur deklarinin fajtor të të pandehurit K. H. për veprën penale “Shpërdorim detyre” dhe dënimin e tij me kohën e paraburgimit.

42.3. Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti, nga ana e Komisionit vlerësohet se sqarimet e subjektit qëndrojnë dhe konkludohet se në këtë rast subjekti i rivlerësimit (i cili ka qenë në grup me dy prokurorë të tjerë) nuk rezulton të ketë vepruar apo të jetë sjellë në mosrespektim të ligjit material dhe procedural, pasi nga dokumentet e paraqitura rezulton se prokurorët mbi bazën e akteve kanë ngritur akuzën “Vrasje me dashje” dhe gjatë fazës së hetimeve paraprake kanë vendosur ndryshimin e saj në përputhje me parashikimet e nenit 287/2 të Kodit të Procedurës Penale. Po ashtu, edhe për sa i përket pasojës, rezulton se gjykata e ka deklaruar fajtor të pandehurin, duke e dënuar me kohën e paraburgimit.

Sa i takon pretendimeve në lidhje me shpërdorimin e detyrës, korrupsionin dhe falsifikimin, ato janë bërë objekt hetimi penal dhe nuk janë në kompetencë të Komisionit.

42.4. Po në lidhje me ngjarjen e tërmetit, pas riçeljes së hetimeve në datën 13.11.2023, pranë Komisionit u administrua denoncim nga z. G. R.⁴⁴, i cili nuk rezulton i regjistruar në RGJC të vitit 2014 (as me emrin G. R.), gjë që ngre pretendime për favorizime të disa shtetasve, të cilët kanë qenë pjesë e hetimeve të dosjes së tërmetit. Me njoftimin e rezultateve shtesë iu kërkua subjektit të japë sqarime e dokumente në lidhje me pretendimet e ngritura në denoncim. Në parashtrimet e tij, subjekti së pari argumenton se:

- Me shumë mundësi kemi të bëjmë me të njëjtin email dërgues si në rastin e trajtuar në paragrafin 46, por që tashmë ka ndryshuar identitet. Në shkrimin e tij ndryshon teknikën duke vënë në vend të “ç” shkronjën “q”, por ruan të njëjtën natyrë shpifjeje në drejtim të tij. Subjekti sqaron se veprimtaria e tij si pjesëtar i grupit hetimor ka qenë tërësisht profesionale dhe e bazuar në prova.

- Në lidhje me procedimin konkret nr. ***, subjekti sqaroi se prokuroria ka ngritur një grup hetimor prej 3 prokurorësh (jo dy). Ashtu si më sipër, sqaroi se në përfundim të hetimeve nga grupi hetimor është vendosur të ngrihen akuza për të pandehurit përkatës dhe çështja është dërguar në gjykim për 16 të pandehur dhe për 2 është kërkuar pushimi i ndjekjes penale. Gjykata Durrës, me vendimin nr. ***, datë 2.2.2021, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës së prokurorëve, duke vendosur dërgimin për gjykim të 14 të pandehurve dhe pushimin për dy të pandehur. Kundër këtij vendimi nga ana e prokurorisë është bërë ankim në Gjykatën e Apelit, e cila me vendimin nr. ***, datë 8.6.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Shkallës së Parë.

- Në seancën e gjyqimit në themel është vendosur ndarja e çështjes penale për të pandehurit, që kanë kërkuar gjykim të shkurtuar me të pandehurit e tjerë. Aktualisht ka përfunduar gjykimi i çështjes me 7 të pandehur, që kanë kërkuar gjykim të shkurtuar. Gjykata Durrës, me vendimin nr. ***, datë 7.11.2022, ka vendosur deklarinin të pafajshëm për 4 të pandehur, ndërsa për 3 ka vendosur deklarinin fajtor. Kundër këtij vendimi nga ana e prokurorisë është bërë ankim në Gjykatën e Apelit, e cila ende nuk ka dalë me vendim. Për dy të pandehur, gjykimi i të cilëve u zhvillua me gjykim të zakonshëm, gjykata me vendimin nr. ***, datë 31.5.2023, ka vendosur deklarinin fajtor, duke i dënuar me kohën e paraburgimit, ndërsa çështjet gjyqësore në ngarkim të të pandehurve të tjerë vazhdojnë gjykimin në Shkallën e Parë.

- Në mbështetje të parashtrimeve të tij, subjekti paraqiti:

i) Vendimin nr. ***, datë 2.2.2021, të Gjykatës së Durrësit, me të pandehur: (a) R. Sh., N. I., Rr. Xh., A. I., A. D., A. T., A. Ç., K. L., F. Gj., A. Q., S. B., A. M., D. Q., A. Q. dhe K. H., me objekt

⁴⁴ Shihni denoncimin nr. *** prot., datë 22.11.2023.

dërgimin për gjykim; (b) A. O. me objekt pushimin e çështjes për shkak të vdekjes, A. D. dhe D. C. pushimin e çështjes, për shkak se nuk provohet kryerja e veprës penale. Gjykata në përfundim ka vendosur dërgimin për gjykim në ngarkim të të pandehurve R. Sh., N. I., Rr. Xh., A. D., A. T., A. Ç., K. L., F. Gj., A. Q., S. B., A. M., D. Q., A. Q. dhe K. H. dhe pushimin e akuzës për të pandehurit A. O., A. T., A. I., D. C. dhe A. D. Sipas shënimit, ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim për të pandehurit A. I. dhe A. T., për të pandehurit A. O., D. C. dhe A. D. ka marrë formë të prerë në datën 17.2.2021.

ii) Ankim ndaj vendimit datë 2.2.2021 të nënshkruar nga grupi hetimor, me të cilin kanë kërkuar ndryshimin e vendimit dhe dërgimin për gjykim në ngarkim të shtetasve A. I. dhe A. T.

iii) Diskutime përfundimtare datë 23.9.2022, të nënshkruara nga grupi hetimor, me të cilat kanë kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurve N. I., A. T., A. Ç., F. Gj., A. Q., S. B. dhe A. D.

iv) Vendim nr. ***, datë 7.11.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas të cilit është vendosur: (a) deklarimi i pafajshëm i shtetasve N. I., A. T., A. Ç. dhe F.Gj.; (b) deklarimi fajtor i shtetasve A. D., S. B. dhe A. Q.

v) Ankim datë 11.11.2022 ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, me anë të të cilit kanë kërkuar ndryshimin e vendimit, duke vendosur sipas kërtimeve në diskutimet përfundimtare.

vi) Vendim nr. ***, datë 31.5.2023, sipas të cilit të pandehurit K. L. dhe K. H. janë deklaruar fajtorë dhe janë dënuar me kohën e paraburgimit.

42.5. Nisur nga përmbajtja e denoncimit, që në thelb pretendimet kanë të bëjnë me korrupsion dhe themelin e çështjes, nga ana e Komisionit vlerësohet se:

- Sa i takon pretendimit se subjekti ka favorizuar të pandehurin F. Gj. duke ia mbyllur çështjen nuk qëndron, për sa kohë që ndaj vendimit të gjykatës për pafajësinë e tij kanë ushtruar ankim duke kërkuar deklarinimin fajtor.

- Sa i takon pretendimit se shtetasve D. C. dhe A. D. subjekti u ka marrë shuma në euro, mbetet i paprovuar dhe në thelb ka të bëjë me themelin e çështjes. Kjo pasi, siç rezulton nga vendimi i gjykatës që ka pranuar pushimin e çështjes ndaj tyre, është arsyetuar se për shtetasin D. C., i cili dyshohej që në kundërshtim me ligjin kishte hartuar aktin e ekspertimit, sipas ekspertimit tekniko-grafik, eksperti ka konkluduar se nënshkrimi nuk është nënshkrim origjinal i D. C. Ndërsa për shtetasin A. D. ka arsyetuar se nuk ka pasur kompetencë të marrë masa të drejtpërdrejta për konvaleshencën, pasi këtë përgjegjësi e kishte përgjegjësi i sektorit të shërbimeve.

- Sa i takon pretendimeve se subjekti dhe prokurorët e tjerë u kanë bërë favore të pandehurve D. Q. dhe A. Q., pasi u kanë marrë shuma lekësh dhe eurosh dhe se nuk u kanë bërë verifikim pasuror, mbeten të paprovuara. Nga ana tjetër, prokurorët edhe për këta të pandehur kanë kërkuar gjykimin e çështjes në ngarkim të tyre për shpërdorim detyre, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata. Sipas vendimit të gjykatës datë 7.11.2022 është kërkuar revokimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar dhe vazhdimi me gjykim të zakonshëm.

43. Në datën 13.11.2023, Komisioni vendosi riçeljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Edmond Koloshi, për arsye se në datën 13.11.2023 u administrua një denoncim i dërguar me email-in e datës 12.11.2023, me dërgues znj. E. Dh., e cila ngre pretendime ndaj subjektit të rivlerësimit Edmond Koloshi dhe prokurorit N. T., të cilët sipas saj janë të korruptuar. Nga përmbajtja e denoncimit ngrihen pretendime në lidhje me procedimin penal nr. ***, datë 13.12.2018, për veprën penale “Shpërdorim detyre”. Me qëllim verifikimin e këtij denoncimi u kryen veprimet si vijojnë:

- Me kërkesë të Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës⁴⁵, duke vënë në dispozicion fashikujt e procedimit penal nr. ***, informoi se procedimi penal nr. ***, viti 2018, në ngarkim të shtetasit A. Q., është hetuar nga prokurori

⁴⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.11.2023, të PPGJSHPJP-së Durrës në dosjen e Komisionit.

A. Sh. Nga verifikimi rezulton që në ngarkim të shtetasit A. Q. të jetë regjistruar edhe procedimi penal nr. ***, viti 2019, i cili është hetuar nga prokurori B. B. dhe aktualisht është në gjykim e përfaqësohet nga prokurorja T. Rr.

- Nga verifikimi i akteve të fashikujve të procedimit penal nr. ***, rezulton se ky procedim është hetuar nga prokurori A. Sh. Sipas formularit mbi përfundimin e çështjes në gjykatë, pasqyrohet se shtetasi A. Q. është hetuar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe nga ana e prokurorisë është kërkuar pushimi i hetimeve, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata me vendimin datë 9.9.2020. Subjekti i rivlerësimit Edmond Koloshi ka nënshkruar në cilësinë si drejtuesi i seksionit aktet si vijojnë: (i) formularin mbi dokumentimin e shortit manual dhe shpërndarjen e materialeve hetimore të referuara në Prokurori, ku rezulton se kallëzimi penal nr. ***, datë 1.2.2018, i është caktuar për ndjekje prokurorit A. Sh.; (ii) shkresat përcjellëse/kërkesa nga prokuroria, pra komunikimet e prokurorisë, të cilat janë firmosur kryesisht nga subjekti i rivlerësimit si drejtues i seksionit, me urdhër dhe delegim drejtuesi.

- Me qëllim kryerjen e verifikimeve të mëtejshme për të evidentuar shkelje të mundshme të subjektit të rivlerësimit, u kërkuar informacion shtesë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës⁴⁶, e cila dokumentoi dhe paraqiti bazën ligjore të gjitha procedurave të ndjekura për shortimin e disa çështjeve nga ana e subjektit, si dhe për nënshkrimin e disa akteve procedurale në cilësinë e drejtuesit të seksionit (në emër të drejtuesit të prokurorisë), trajtuar hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ shtesë. Në analizë të çdo dokumenti dhe informacioni ligjor, në përfundim të procesit, pretendimet e ngritura në denoncim nuk u gjendën të bazuara, pasi: (i) nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer veprime hetimore në lidhje me procedimin nr. ***, sikurse pretendohet në denoncim, për shkak se hetimet për këtë procedim janë ndjekur nga një prokuror tjetër; (ii) u vërtetua që subjekti ka vepruar në përputhje me rregullat përkatëse e dispozitat ligjore/nënligjore për materialin kallëzues nr. ***, datë 1.2.2018.

44. Ministria e Drejtësisë⁴⁷ ka informuar se ndaj subjektit Edmond Koloshi janë paraqitur 2 ankesa nga shtetasi V. V. (në thelb kanë të bëjnë me pretendimet e ngritura në denoncim në lidhje me procedimin nr. ***), për të cilat Ministria ka njoftuar se çështja ndodhet në gjykim. Shtetasi Sh. I. ka paraqitur ankesë ndaj subjektit të rivlerësimit dhe gjyqtarëve, për të cilën Ministria ka informuar se veprimet e prokurorit janë shqyrtuar nga gjykata, si dhe e ka orientuar t'i drejtohet Prokurorisë së Përgjithshme. Nga verifikimi i ankesës së shtetasit Sh.I., Komisioni vlerësoi se ai nuk përmban fakte dhe rrethana për hetime të mëtejshme.

Rivlerësimi profesional sipas kritereve të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

45. Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias⁴⁸ dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese⁴⁹, të cilat kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjytimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, Komisioni nuk i çmoi problematikat e evidentuara dhe të trajtuara hollësisht në këtë vendim si shkaqe që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të shkronjës “e” të Aneksit të Kushtetutës, apo që ta bëjnë atë të papërshtatshëm në drejtim të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

⁴⁶ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 23.11.2023, të PPGJSHPJP-së Durrës në dosjen e Komisionit.

⁴⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2023, të Ministrisë së Drejtësisë në dosjen e Komisionit.

⁴⁸ Shihni opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias.

⁴⁹ Shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

SEANCA DËGJIMORE

46. Në datat 13.11.2023 dhe 5.12.2023, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvilluan seancat dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Edmond Koloshi, në përfundim të të cilave ai kërkoi konfirmimin në detyrë. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisioneren Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Edmond Koloshi dhe shpalli vendimin në seancën e datës 7.12.2023, sipas pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

47. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë në çdo rast i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi u është përgjigjur me korrektësi dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjet, duke dhënë shpjegime/deklarime për informacionin e kërkuar bazuar në dokumente shkresore, të cilat kanë qenë konsistente dhe në koherencë të plotë me deklaratimet ndër vite dhe atë *Vetting*, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion PËRFUNDIMTAR

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe në parimin e proporcionalitetit sipas pikës 5 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Edmond Koloshi ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë sipas nenit 59/a të ligjit.
- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit Edmond Koloshi ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit.
- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Edmond Koloshi ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe në pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Edmond Koloshi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 7.12.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Firdes SHULI
Relatore

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Jonida Vrana